



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 75/43 Prot.

Tiranë më, 28.02.2025

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. ILIR ISUF SULA

Nr. 3, datë 28.02.2025.

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Elida Domi	Relator
Ersa Karaj	Kryesues
Erjana Pjetri	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Ledjana Azemaj, më datë 28.02.2025, ora 13¹⁵, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Ilir Isuf Sula**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Shkodër - Lezhë.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes znj. Elida Domi, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar.

2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar, shtetasi Ilir Isuf Sula është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupa e Vlerësimi të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Shkodër - Lezhë.

3. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. *****, datë 31.01.2023, gjatë fazës së hetimit administrativ, z. Ilir Sula, është emëruar me detyrë Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Shkodër - Lezhë, funksion organik i parashikuar në nenin 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

4. Subjekti i vlerësimit, z. Ilir Isuf Sula, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023 *“Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për Trupat e Vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit”* të Ligjit nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar.

5. Në zbatim të legjisllacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. **, datë 28.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: znj. Ersja Karaj (Kryesuese), z. Klevis Dhigoi (Relator) dhe znj. Erjana Pjetri (Anëtare).

6. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “*Për hapat procedural të unifikuar*”, me Vendimin Nr. ** Prot., datë 28.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Ilir Isuf Sula.

7. Relatori i çështjes, z. Klevis Dhigoi, i zëvendësuar, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 02.08.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, ku i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit. Bazuar në Vendimin nr.5, datë 22.01.2025, të Trupës së Vlerësimit, është vendosur zëvendësimi i një anëtari z. Klevis Dhigoi me znj. Elida Domi, në cilësinë e relatorit. Relatori i çështjes, znj. Elida Domi, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 22.01.2025, ka njoftuar subjektin e vlerësimit, për ndryshimin e relatorit..

8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 03.08.2023 dhe më datë 27.01.2025, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

-  Vlerësimin e pasurisë;
-  Kontrollin e figurës;
-  Vlerësimin e aftësive profesionale.

10. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:

- Formularin e deklarimit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. ** Prot., datë 31.07.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
- Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. ** Prot., datë 31.07.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- Formularin e Kontrollit të Figurës me shkresë përcjellëse Nr. ** Prot., datë 31.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:

- Vlerësimin e pasurisë;
- Kontrollin e figurës;

➤ Vlerësimin e aftësive profesionale.

13. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
- Ligjin nr. 12/2018, *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 128/2021, *“Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”*;
 - Ligjin nr. 40/2015, *“Kodi i Procedurës Administrative”*;
 - Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”*;
 - Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023 *“Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar’ ”*;
 - Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI Nr.15, datë 27.01.2023, *“Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, ‘Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, i ndryshuar”*;
 - Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, *“Për hapat procedural të unifikuar”*.
14. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:
- ❖ Deklaratën e Pasurisë;
 - ❖ Deklaratën për Kontrollin e Figurës;
 - ❖ Formularin e Vlerësimit Profesional;
 - ❖ Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;
 - ❖ Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
 - ❖ Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;
 - ❖ Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;
 - ❖ Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
 - ❖ Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
 - ❖ Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
15. Trupa e Vlerësimit më datë 10.02.2025, pasi dëgjoi relatorin, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, me Vendimin Nr. **, datë 10.02.2025, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Ilir Isuf Sula.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët: vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe të paraqesë shpjegime.

16. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”*.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, më datë 19.02.2025, ora 11⁰⁰, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.

18. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

19. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 28.02.2025.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

20. Subjekti i vlerësimit z. Ilir Isuf Sula, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

21. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtura, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

23. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Ilir Sula, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 10.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi **, viti 2023.

24. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

25. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

26. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

27. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

28. **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklarinimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

29. **Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:**

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

30. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

30.1 Shtetasi Ilir Sula është bërë subjekt deklarimi në ILDKPKI-së, në vitin 2003, me numër indeksi ****. Në zbatim të ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”*, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë.

30.2 ILDKPKI-ja përveç sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”*, i ndryshuar, në datë 22.8.2023, ka marrë në shqyrtim *“Deklarata e pasurisë për vlerësimin kalimtar, vetting, e subjektit Ilir Sula”*.

Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ilir Sula, ILDKPKI-ja ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, vetting dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj, të dorëzuar nga vetë subjekti, deklaratat e interesave privatë ndër vite, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr. ** Prot., datë 23.08.2023, pranë institucioneve të ndryshme.

30.3 Në përputhje me Ligjin Nr.9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”*, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”*, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm Nr. ** Prot., datë 18.03.2024, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i pasaktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, ILIR ISUF SULA

31 Pasuria nr. 1

Pasuri e paluajtshme, truall me sip. 437.55 m² dhe ndërtesë me sip. 145.85 m², ku pjesa më e madhe e përqindjes së pasurisë, ka qenë e pjesëtarëve të tjerë të familjes (trashëgimtarë të babait të subjektit), të cilët ja kanë dhuruar subjektit, me akt-dhurimi. Pasuria ndodhet në ZK. ***, Tiranë. Krijimi i kësaj pasurie ka qenë nga viti 2001 e në vazhdim, e cila akoma nuk është përfunduar. Rivlerësimi i kësaj pasurie është në vlerën 16.369.080 lekë.

31.1 Shpenzime për legalizimin e truallit në Drejtorinë Vendore të ASHK Kamzë-Vorë, më datë 10.12.2021, janë në shumën 398.521 lekë.

31.2 Shpenzime për ALUIZNIN, kryera më datë 10.12.2021, me bono privatizimi, në shumën 560.000 lekë.

31.3 Shpenzime nga rivlerësimi i pasurisë 3%, plus komisione dhe të ardhura nga shërbimi i kryer më datë 20.10.2021, në shumën 126.811 lekë.

Pjesa takuese: 50%.

Dokumentacioni i marrë në shqyrtim:

31.4 Certifikatë regjistrimi pronësie për pasurinë nr. *** ZK.1066, e llojit “truall” me sip.437.55 m², nga e cila ndërtesë me sip.145.85 m², në emër të subjektit Ilir Sula, me pjesë takuese 100%.

Bashkëlidhur;

- *Kartela e Pasurisë së paluajtshme, ku konfirmohet regjistrimi i pasurisë në datë 06.05.2022, në emër të subjektit Ilir Sula, nëpërmjet Kontratës së Dhurimit nr. ***, datë 01.02.2022. Në seksionin "e" me shënimin: Vendim Leje Legalizimi nr.***, datë 09.08.2021; Godinë banimi 4 kate, me sip. kati përdhe ndërtim + banim 145,85 m²; sip. kati i parë sip. ndërtimi 200.05 m², sip. shkallë 10.15 m², sip. banimi 210.20 m²; sip. kati i dytë ndërtim + banim 200.05 m², sip. kati i tretë ndërtim + banim 199.40 m².*

31.5 Certifikatë regjistrimi pronësie për pasurinë nr. **** ZK. 1066, e llojit “truall”, në emër të Ilir Sula, me pjesë takuese 7/12.

Bashkëlidhur;

- *Kartela e Pasurisë së paluajtshme në emër të 11 bashkëpronarëve, ku konfirmohet fitimi i pasurisë në datë 21.01.2022, nëpërmjet vendimit për kalim pronësie nga ASHK. Në seksionin "e" me shënimin: Vendim Leje Legalizimi nr. ****, dt. 09.08.2021;*

31.6 Kërkesë nr. *****, datë 19.10.2021, pranë ASHK-së.

Bashkëlidhur;

- *Bashkëlidhur tabela e përlllogaritjeve të R.V.P për individët. Pasuria rivlerësohet në shumën 16.369.080 lekë. Tatimi 123.891 lekë.*
- *Kartela e pasurisë së paluajtshme nr.***-ND, ndërtesë me sip. 145.85 m², në emër të 11 bashkëpronarëve, ndër ta edhe Ilir Sula, regjistruar në dt. 29.09.2021, me Leje Legalizimi,*

*me përshkrimin e veçantë “Leje Legalizimi nr.***, dt. 09.08.2021; Godinë banimi 4 kate, sip. kati përdhe ndërtim + banim 145,85 m2; sip. kati i parë sip ndërtimi 200.05 m2, sip. shkalle 10.15 m2, sip. banimi 210.20 m2; sip kati i dytë ndërtim + banim 200.05 m2, sip. e kati i tretë ndërtim + banim 199.40 m2.*

31.7 Faturë pagese në Credins Bank, datë 10.12.2021, nga subjekti Ilir Sula, e shumës 398.521 lekë, për Drejtorinë Vendore të ASHK Kamzë - Vorë.

31.8 Faturë pagese në Credins Bank, datë 10.12.2021, nga subjekti Ilir Sula, e shumës 560.000 lekë, për ALUIZNI-in në bono privatizimi.

Bashkëlidhur:

- Njoftim për likuidimin të faturës për pagesën e parcelës ndërtimore nr. **** prot, datë 07.12.2021, nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë - Vorë.
- Mandat arkëtimi nga subjekti Ilir Sula, për ZVRPP Kamzë -Vorë, në shumën 126.811 lekë, në datë 20.10.2021.

32 HETIMI ADMINISTRATIV

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, kanë kryer hetimin administrativ, nga ku rezulton se:

32.1 **Drejtoria Vendore e ASHK-së, Kamzë - Vorë,** me shkresën nr. *** prot, datë 19.10.2023, konfirmon se subjekti Ilir Sula, nuk ka pasur vetdeklarim për legalizim, por ka përfituar një pasuri me legalizim “objekt 4 kate”, me Vendim nr.***, datë 09.08.2021, sipas Deklaratës Noteriale nr.Rep. ***, nr. Kol*** të datës 25.03.2021, për heqje dorë nga procedura e legalizimit e shtetasit F. Sula (vëllai i subjektit). *Bashkëlidhur dokumentacioni justifikues.*

32.2 **Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë - Vorë,** me shkresën nr.*** prot, datë 08.01.2024, konfirmon se shtetasi F. Sula dhe Isuf Sula (babai i subjektit), kanë aplikuar me vetdeklarimin nr. *** Prot., më datë 09.11.2006, për objektin informal, shtëpi banimi, e cila është legalizuar dhe regjistruar në emër të subjektit Ilir Isuf Sula, e fituar me deklaratë noteriale për heqje dorë nga pronësia nga trashëgimtarët e të ndjerit Isuf Sula. Bashkëlidhur dokumentacioni justifikues:

Bashkëlidhur:

- Vetdeklarimi dhe dosja e lejes së legalizimit nr. *** Prot., më datë 09.11.2006, për objektin informal, shtëpi banimi, ZK ***.
- Genplan i objektit me nr. pasurie ***.
- Planimetria e objektit.
- Akt Evidentimi nr. ***, datë 02.07.2021, nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë - Vorë, për objektin pa leje.
- Vendim nr. ***, datë 09.08.2021, nga Drejtoria Vendore ASHK-së Kamzë - Vorë, për legalizimin e ndërtimit pa leje.

- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Tashëgimisë Ligjore nr.*** Rep, nr.***Kol, datë 25.08.2021, për trashëgimlënësin të ndjerin Isuf Sula.
- Prokurë e Posaçme nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 02.09.2021, në të cilën trashëgimtarët ligjor të të ndjerit Isuf Sula, emërojnë si përfaqësues të posaçëm të tyre subjektin Ilir Sula, duke i dhënë tagër përfaqësimi të nënshkruajë kontratë dhurimi/shitje për të gjitha pronat që ka pasur i ndjeri Isuf Sula. Gjithashtu i kalojnë tagër përfaqësimi që të ndjekë **tw** gjith**w** procedurën bankare në lidhje me të ardhurat që përfitojnë nga kjo pasuri, duke ja kaluar vetes apo të tretëve.
- Deklaratë Noteriale nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 23.07.2020, për korrigjimin i hartës në ASHK Tiranë sipas Plan Rilevimit.
- Deklaratë Noteriale nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 02.08.2021, nga shtetasist H.K, S.K dhe H.A, me cilësinë e bashkëpronarëve në pasuritë kufitare, ku deklarojnë se janë dakort që objekti i shtetasit Ilir Sula, të legalizohet, pasi nuk kanë asnjë pretendim juridiko financiar, as sot dhe as në të ardhmen.
- Kartela e pasurisë nr. *** - ND, me sipërfaqe 145.85 m², me vlerë fillestare të pasurisë 1 lekë, sipas Aktit nr.***, datë 09.08.2021, rivlerësuar në shumën 16.369.080 lekë, sipas Aktit nr.***, datë 25.10.2021, në emer të Ilir Sula, me pjesë takuese 7/12 pjesë dhe e 10 bashkepronarëve të tjere.
- Deklaratës Noteriale nr.Rep. ***, nr. Kol*** të datës 25.03.2021.
- Njoftim për likuidimin e faturës për pagesën e parcelës ndërtimore, nr. *** prot, datë 09.08.2021.
- Kërkesë për afishim publik nr. *** prot, datë 09.08.2021, nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamëz - Vorë, për pasurinë e ndodhur në ZK 1066.
- Praktika e regjistrimit të blerjes së parcelës ndërtimore.
- Regjistrimi i kontratës së dhurimit dhe konkretisht; Kontratë Dhurimi pasuri e paluajtshme, nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 01.02.2022, në zonën kadastrale nr. 1066.
- Si dhe dokumentacion i nevojshëm për justifikimin e pasurisë së sipërcituar.

32.3 Me inventarin nr. extra Prot. të datës 07.12.2023, subjekti ka dorëzuar dhe ka dhënë shpjegimi si më poshtë: “... *I gjithë objekti ka kaluar në pronësinë e tij me Akt-Trashëgimie, me Deklaratë për Heqje Dorë dhe Akt-Dhurimi nga anëtarët e familjes dhe trashëgimtarët e të ndjerit Isuf Sula. Për dhurimin e pasurisë, bashkëpronarët e tjerë, nuk kanë pasur asnjë arsye për dhurimin e saj, por është bërë me vullnetin e tyre të lirë.*

Në lidhje me shumën e investimit, ka sqaruar se, nuk janë mbajtur raporte për investimin e kryer, pasi në ndërtimin e objektit është investuar në periudha të ndryshme kohore, nga familja e subjektit dhe familja e vëllait të tij shtetasit F. Sula, gjithashtu dhe prindërit e subjektit.

Si dhe ka sqaruar faktin se akt-vlerësimi i pasurisë është në vlerën 16.369.080 lekë dhe pjesa e tij në këtë investim ka qenë 50% gjatë gjithë periudhës.

Trualli mbi të cilin është ndërtuar pasuria e lartpërmendur, ka qenë truall shtet, i marrë nga vëllai i tij, shtetasi F. Sula, në vitin 1993 dhe pas marrjes së lejes së legalizimit të banesës, është bërë pagesa nga subjekti, për vlerën në metër katror, sipas çmimit të zonës fiskale nga ekspertët e pasurisë.

Bashkëlidhur:

- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Tashëgimisë Ligjore nr.*** Rep, nr.***Kol, datë 25.08.2021, për trashëgimlënësin të ndjerin Isuf Sula.
- Deklaratë Noteriale nr.*** Rep, nr.***Kol, datë 25.03.2021, për heqje dorë nga pronësia apo bashkëpronësia.
- Deklaratë Noteriale nr.*** Rep, nr.***Kol, datë 05.12.2023, nga shtetasit F. Sula dhe Ilir Sula, në të cilën subjekti ka deklaruar se është pronar i pasurisë së sipërcituar, dhuruar nga vëllai i tij, shtetasi F. Sula dhe trashëgimtarët e të ndjerit Isuf Sula.
- Si dhe dokumentacion i nevojshëm për justifikimin e pasurisë së sipërcituar.

32.4 Me inventarin e datës 14.12.2023, subjekti ka dorëzuar materialet si më poshtë:

- Foto të ndërtesës 4 katëshe, si dhe të mobilimit të brendshëm të banesës.
- Formularë deklarimi mbi të ardhurat dhe kthimi i taksave (Tax Return), për vitet 2016 – 2023, për djalin e subjektit, shtetasi I. Sula, me banim në Londër, Angli.

32.5 Me inventarin nr. extra Prot. të datës 19.12.2024, subjekti ka dorëzuar materialet dhe dhënë shpjegimi si më poshtë: *“...Unë Ilir Sula, sqaroj se familja ime dhe vëllai im para viteve 1990 ka jetuar në Surroj - Kukës dhe pas vitit 1990, si rrjedhojë e lëvizjeve demografike të popullsisë për një jetë më të mirë sociale dhe arsimore, për antarët e dy familjeve vendosëm që të lëviznim nga Kukësi duke ardhur me banim në Paskuqan -Tiranë. Sqaroj se vëllai im, F. Sula ka punuar në ndërmarje të ndryshme shtetërore deri në vitin 1990 (bashkëngjitur dokumentacioni justifikues), ndërkohë që pasi është ndryshuar sistemi ai punonte si shofer me makina të mëdha transporti dhe ishte i vetëpunësuar.*

Gjithashtu, sqaroj se para se të vinim në Tiranë, vëllai im, F. Sula i kishte blerë një shtetasi në Tiranë tokën ku ne jetojmë dhe sot, vlerën e të cilës e kam deklaruar në deklaratat e mëparshme. Në Tiranë kemi ardhur në vitin 1993, por kemi filluar të ndërtonim banesën me vëllain, prindërit dhe fëmijët në vitin 2001. Ndërtimi i objektit si konstruksion është bërë në vitin 2001, fakt të cilin e vërtetoj me fotot e vendosur në dispozicion të trupës vlerësuese.

Unë dhe bashkëshortja ime, kemi qenë të punësuar në shtet: Unë punoja oficer policie dhe bashkëshortja mjeke "Pneumologe". Vëllai im ka 5 fëmijë, 3 djem dhe 2 vajza, të gjithë të martuar dhe në moshë madhore. Ndërsa unë kam 3 fëmijë "djem". Sqaroj se fëmijët e vëllait, prej shumë vitesh jetojnë në Angli, me dokumentacion të rregullt, ashtu si dhe dy fëmijët e mi të rritur, ku njëri djalë, është i martuar dhe jeton me dokumentacion të rregullt në SHBA, dhe djali tjetër, jeton në Angli me letra të rregullta.

Në lidhje me investimin e ndërtimit dhe perjudhën e ndërtimit të objektit, sqaroj se deklaratat e mia kanë qenë disi kontradiktore për shkak të një kohe të gjatë mbi 30 viteve, por procesi i investimit është bërë nga anëtarët e familjes time dhe vëllait, ku nuk kemi mbajtur inventarin e shpenzimeve.

Kërkesat për procesin e legalizimit të objektit janë bërë pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kamëz – Vorë, nga ana e vëllait tim, F. Sula, në kohën e procesit të legalizimit në vitin 2006.

Sqaroj se investimi i objektit ka qenë pothuajse gjysmë për gjysmë mes familjes së vëllait dhe familjes time. Në investimin e kësaj pasurie, ne nuk kemi mbajtur numrin e shpenzimeve në lekë për individ, por kjo ka qenë kontribut nga 2 familjet dhe i prindërve, investimi në 2 objektet janë afersisht 50% me 50%. E cila pasqyrohet në kontratën e fundit me akt notarial të vitit 2023.

Gjithashtu, sqaroj se nuk kemi bërë projekt banese me inxhinier, pasi është ndërtuar pa projekt inxhinierik, nga vitet 1993-2001. Unë kam jetuar në këtë ndërtesë që nga koha e krijimit të saj, me prindërit dhe me familjen e vëllait tim.

Pasuria e lartëpërmendur sipas dokumentacioneve përkatëse, është në emërin tim, me pjesë takuese 100%.

Gjithashtu, dua të sqaroj se kemi një objekt prej 25 m², magazinë materialesh, të ndërtuar në vitet 2001. Kjo vërtetohet edhe në fotot e nxjerra nga programi ortofoto i ASIG. Procedurat e Kërkesës së legalizimit i ka bërë vëllai im, F. Sula, gjatë vitit 2006, pasi unë isha në punë shteti dhe nuk kisha mundësi të merresha me këtë proces.

Bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, e datës 06.05.2022.
- Kontratë dhurimit nr. ***, datë 01.02.2022.
- Vendim Leje Legalizimi nr. ***, datë 09.08.2021.
- Certifikata e regjistrimit të pronësisë për pasurinë nr. *** ZK. ***.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, e datë 21.01.2022.
- Akt-vlerësimi i pasurisë nga ASHK, e cila është në shumën 16.369.080 lekë.
- Vërtetim pune F. Sula (fotokopje).
- Vërtetim page I. Sula & A. Sula (Anglisht).
- Deklaratë I. Sula (Anglisht).
- Deklaratë M. Sula për mjetin Golf.
- Printim nga E-gjopa për mjetin TR***J.
- Faturë tatimore blerje TR***J (fotokopje).
- Faturë tatimore blerës I. Sula, mjet TR***D.
- Faturë tatimore blerje L***C (fotokopje).
- Faturë tatimore shitje I. Sula, mjet TR***D.
- Foto të objektit në pronësi të subjektit Ilir Sula.

Gjithashtu gjatë hetimit administrativ janë dorëzuar nga subjekti, dokumenta justifikues, ndër të tjera si më poshtë:

- E-mail nga subjektit Nr.*** Prot., datë 02.08.2023.
- Ortofoto të objektit ASIG.
- Deklaratë nga shtetasi F. Sula, nr. *** prot, datë 02.08.2024.
- e-mail sqarues nga subjekti, i datës 20.08.2024.
- Dërgim dokumentesh nga subjektit nr.*** Prot., datë 19.06.2024.
- Curriculum Vitae, nga subjekti Ilir Sula.
- Vërtetim Punësimi për shtetasin L. Sula, datë 8.03.2023.
- Dokumentacion tjetër i nevojshëm justifikues.

33 Bazuar në dokumentet dhe deklaratimet e administruara mbi pasurinë nr.1, gjatë hetimit administrativ, është konstatuar si vijon:

33.1 Në lidhje me pasurinë truall dhe ndërtesë banimi, ka rezultuar se, viti i ndërtimit dhe investimi në të, ka pasur deklaratime të ndryshme nga subjekti, konkretisht si vijon:

- Në deklaratën e pasurisë në viti 2023, dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka deklaruar si vit krijimi 2001 e në vazhdim ndër vite, e cila akoma nuk është përfunduar;

- Në deklarimet e pasurisë së subjektit ndër vite pranë ILDKPKI-së; ka deklaruar si vit krijimi vitin 2000;
- Në deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pranë ILDKPKI-së dhe trupës së vlerësimit, ka deklaruar vit krijimi 1993 – 2006.
- Përsa i përket investitorëve të kësaj pasurie, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se, *“Familjet e tij dhe të vëllait kanë jetuar sëbashku si dhe dy prindërit e tyre. Pjesëmarrës në ndërtimin e këtij aseti kanë qenë të gjithë familjarët në moshë madhore. Investimi ka qenë në mënyrë të barabartë mes tij dhe vëllait. Burim i krijimit financiarë deklararon se kanë qenë të ardhurat nga pagat e tij, dhe të bashkëshortes, të ardhurat nga pensionet e prindërve, të ardhura nga punësimi i vëllait shtetasit F. Sula ndër vite si dhe nga të ardhurat e fëmijëve të vëllait që ishin në emigrim.*

33.2 Referuar fakteve të mësipërme, subjekti ka dhënë sqarime për këto “gabime materiale/pasaktësi” të bëra prej tij, drejtuar ILDKPKI-së me arsyetimin “...për shkak të kohës së largët dhe për mos mbajtjen e numrit të saktë të shpenzime për arsye sepse kjo pasuri është e krijuar me kontributin e pjesëtareve të familjes...”.

33.3 Gjithashtu ka dhënë sqarime pranë Trupës së Vlerësimit nëpërmjet postës elektronike datë 15.05.2024 dhe 16.09.2024, ku shprehet se: “...në lidhje me burimin e krijimit për pasurinë e deklaruar kanë kontribuar të gjithë anëtarët e familjes, për këtë arsye nuk është parë e arsyeshme mbajtja e shpenzimeve për këtë pasuri”.

33.4 Në lidhje me vitin e ndërtimit të pasurisë ndërtesë me sip.145.85 m², në Kodër Kuqe, Paskuqan – Tiranë, subjekti i vlerësimit ka paraqitur **“ortofoto ASIG”** të pasurisë së deklaruar në të cilën rezulton ndërtim i vitit 2001, si dhe **foto të ambienteve të brendshme** të kësaj pasurie ku nuk janë kryer ndërtime/punime të tjera përveç atyre çfarë ka deklaruar subjekti i vlerësimit.

33.5 Mbi burimin e të ardhurave, nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucionet ligjzbatuese si dhe ato të administruara nga vetë subjekti, Trupa e Vlerësimit ndër të tjera ka konstatuar se, shtetasi F. Sula (vëllai i subjektit), gjatë periudhës 1985 – 1993 ka qenë i punësuar si punëtor në N.D.Rruga, shofer në Ndërmarrjen Gjeologjike, Kukës, si dhe i punësuar si shofer pranë Parkut Automobilistik të Mallrave Kukës. Drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore Kukës, me vërtetimin e datës 12.02.2016, vërteton se shtetasi F. Sula ka qenë i siguruar nga puna si shofer. Pas vitit 1993 shtetasi F.Sula ka qenë i vetepunësuar në sektor privat, i pa regjistruar në organet përkatëse.

33.6 Trupa e Vlerësimit, referuar dokumentacionit dhe kthim përgjigje nga ASHK, në lidhje me legalizimin e objektit ka konstatuar se, më datë 09.11.2006, babai dhe vëllai i subjektit, shtetasit Isuf Sula dhe F. Sula, kanë kryer procedurat e vetdeklarimit dhe kërkesën për legalizimin e objektit pa leje, shtëpi banimi në adresën Kodër e Kuqe, Lagjja nr. 1. Viti i ndërtimit 2001, ku sipërfaqja e zënë është 1.000 m², sip. ndërtimi 132 m², objekt 4 katësh. Fakt i cili konfirmohet nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën e datës 08.01.2024.

33.7 Referuar Deklaratës Noteriale të datës 23.07.2020 dhe 02.08.2021, pronarët kufitarë me pronën e sipërpërmendur, që kufizohen sipas Plan Rilevimit, japin dakordësinë dhe deklarojnë se nuk kanë pretendime mbi korrigjimin e hartës pranë ASHK-së. Fakt i cili konfirmohet nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën e datës 19.10.2023.

33.8 Pas njoftimit për likuidim fature për pagesën e parcelës ndërtimore të datës 07.12.2021, likuidimi i detyrimeve është kryer nga subjekti në Credins Bank, sipas faturës së datës 10.12.2021, në shumën 398.521 lekë dhe në Bono Privatizimi në shumën 560.000 lekë. Fakt i cili konfirmohet nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën e datës 19.10.2023.

33.9 Është administruar Certifikatë Regjistrimi pronësie e datës 29.09.2021 dhe kartelë pasurie e paluajtshme e datës 21.01.2022, në emër të 11 bashkëpronarë, ku konfirmohet fitimi i pasurisë së lartë përmendur, me vendim legalizimi të datës 09.08.2021. Fakt i cili konfirmohet nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën e datës 19.10.2023.

33.10 Referuar Deklaratës Noteriale datë 25.03.2021, Aktit të Trashëgimisë datë 25.08.2021, Prokurës së Posaçme datë 02.09.2021 dhe Kontratës së Dhurimit datë 01.02.2022, trashëgimtarët ligjor të babait të subjektit, të ndjerit Isuf Sula, emërojnë si përfaqësues të posaçëm të tyre subjektin Ilir Sula, të cilit i japin tagër përfaqësimi të nënshkruajë kontratë dhurimi/shitje, për të gjitha trashëgimtarët që ka i ndjeri Isuf Sula, si dhe i japin tagër përfaqësimi që të ndjekë të gjithë procedurën bankare në lidhje me të ardhurat që përfitojnë nga kjo pasuri, duke ja kaluar vetes apo të tretëve. Fakt i cili konfirmohet nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën e datës 08.01.2024 dhe inventarin e datës 07.12.2023.

33.11 Trupa e Vlerësimit ka administruar mandatpagese nga subjekti Ilir Sula, datë 20.10.2021, në shumën 126.811 lekë, për rivlerësim pasurie, shoqëruar me formularin e përlllogaritjes së R.V.P për individët. Çmimi i referencës është përlllogaritur 16.369.080 lekë dhe shuma që duhet paguar 123.891 lekë. Kartela e pasurisë së paluajtshme nr.*** Zk.****, ndërtesë me sip. 145.85 m², në emër të 11 bashkëpronarëve. Fakt i cili konfirmohet me inventarin e datës 07.12.2023.

33.12 Trupa e Vlerësimit, pas analizimit në tërësi të informacionit të administruar, ka konstatuar se deklaratimet e ndryshme mbi ndërtimin dhe vitin e krijimit të pasurisë ndërtesë me sip.145.85 m², në Kodër Kuqe, Paskuqan – Tiranë, janë konsideruar si gabime materiale nga subjekti i vlerësimit.

33.13 ASHK konfirmon pasurinë e deklaruar, truell me sip. 437.55 m² dhe ndërtesë me sip.145.85 m², në Kodër Kuqe, Paskuqan - Tiranë, të regjistruar në pronësi të subjektit Ilir Sula, me pjesë takuese 100%.

33.14 Subjekti ka deklaruar shpenzime për blerjen e truallit në ASHK dhe rivlerësimin e pasurisë në shumën totale rreth 520.000 lekë dhe me Bono Privatizimi në shumën 560.000 lekë, ndërsa shpenzime për mobilim shtëpie deri në datën 10.03.2023, në shumën rreth 700.000 - 800.000 lekë.

Trupa e Vlerësimit, në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklaratimit të subjektit, dokumentacionit justifikues (ortofoto ASIG të pasurisë së deklaruar në të cilën rezulton ndërtim i vitit 2001, foto të ambienteve të brendshme të kësaj pasurie ku nuk janë kryer ndërtime/punime të tjera përveç atyre çfarë ka deklaruar

subjekti i vlerësimit), si dhe të dhëna të mbledhura nga institucionet ligj zbatuese, konstaton se:

✓ Konfirmohet pasuria e deklaruar nga subjekti i vlerësimit (truall me sip. 437.55 m² dhe ndërtesë me sip.145.85 m², në Kodër Kuqe, Paskuqan - Tiranë.

✓ Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së sipërcituar, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, në të cilin thuhet se “...subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 e në vijim...”, rezulton se aset i sipërpërmendur është krijuar para vitit 2008.

34 Pasuria nr. 2

Në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, ndër të tjera subjekti ka deklaruar: “*Disponoj me pjesëtarët e tjerë të familjes një ndërtesë të vogël njëkatëshe, me sipërfaqe 25m², të pandarë, të cilën e kemi në proces legalizimi.*”

34.1 Me postën elektronike të datës 16.09.2024, subjekti është pyetur nga Trupa e Vlerësimit, në lidhje me ndërtimin e objektit prej 25 m², ka dhënë sqarime si më poshtë: “*...Ky objekt ka filluar së ndërtuari si magazinë për mbajtjen e materialeve para vitit 2000, ku datën se mbaj mend për shkak të kohës së gjatë dhe ka përfunduar në vitin 2006, me kontributin e anëtarëve të familjes së vëllait F. Sula dhe me kontributin e anëtareve të familjes time, ku gjurma e saj gjendet dhe në ortofoto të ASIG të vitit 2001. Vëllai im, shtetasi F. Sula e ka sqaruar këtë fakt dhe në deklaratën e tij personale se deklarimin e saj tek ALUIZNI e ka bërë në vitin 2006, për të dy objektet.*”

34.2 Gjithashtu subjekti sqaron se ka kërkuar informacion pranë ALUIZNI-t, lidhur se në çfarë faze të procesi të legalizimit është objekti i ndërtesës prej 25 m² por nuk ka marrë një përgjigje nga ky institucion ...”.

34.3 Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, me shkresën nr. ***, datë 19.10.2023, nuk konfirmon objektin e deklaruar nga subjekti në proces legalizimi.

Trupa e Vlerësimit, pas analizimit të informacionit dhe dokumentacionit të administruar, ka konstatuar se:

✓ Gjurma e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 25 m² gjendet dhe në ortofoto të ASIG të vitit 2001.

✓ Vëllai i subjektit, shtetasi F. Sula, ka sqaruar se së bashku me pasurinë nr. 1, ka deklaruar edhe këtë objekt tek ALUIZNI në vitin 2006. (*bashkëlidhur deklarata*).

✓ Bashkëngjitur shkresës nr.***, datë 04.01.2024, Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamzë Vorë, që ka dërguar pranë ILDKPIK-së, mbi dosjen e lejes së legalizimit të datës 09.11.2006, nga shtetasi F. Sula dhe Isuf Sula, për shtëpi banimi në adresën Kodra e Kuqe, Lagjja nr.1, gjenden dhe foto të objektit njëkatësh me sip. 25m².

Mbi burimin e krijimit të pasurisë:

✓ **Trupa e Vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklarimit të subjektit, dokumentacionin justifikues (ortofoto ASIG të pasurisë së deklaruar në të cilën rezulton ndërtim i vitit 2001), konstaton se objekti është ndërtuar para vitit 2008.**

✓ **Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së sipërcituar, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, në të cilin thuhet ; “...subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 e në vijim...”, rezulton se aset i sipërpërmendur është krijuar para vitit 2008.**

35 **Pasuria nr. 3**

Gjendje cash, jashtë sistemit bankar, në shtëpi në shumën 50.000 lekë. Zotëron 50% .

✓ **Trupa e Vlerësimit, pasi kreu analizën financiare mbi mundësinë për kursim për krijimin e kësaj pasurie, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash të deklaruar.**

36 **Pasuria nr. 4**

Depozitë bankare në shumën 2.00.000 lekë.

Burimi i krijimit: Nga kursimet ndër vite nga të ardhurat në punë me bashkëshorten. Llogaria bankare e depozitës financiare është në emër të bashkëshortes.

Zotëron: 50%

Bashkëlidhur:

- Nxjerrje llogarie depozite nga Abi Bank, në emër të shtetases Th. Sula, datë 06.03.2023. Konfirmohet depozitë në monedhën lekë, hapur më datë 12.07.2022, në shumën 2.000.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie kursimi nga Abi Bank, në emër të shtetases Th. Sula, datë 06.03.2023. Konfirmohet depozitë në monedhën lekë, hapur në datë 12.07.2022, në shumën 2.000.000 lekë. *(Nga nxjerrja e llogarisë konfirmohet llogari kursimi, për periudhën 26.04.2019 – 28.03.2022, në shumën 800.000 lekë. Shtuar shuma 1.158.000 lekë, në datë 12.07.2022 dhe shuma totale prej 2.000.000 lekë, kaluar në depozitë).*

37 **HETIMI ADMINISTRATIV**

37.1 ABI Bank, me shkresën e datës 04.09.2023, konfirmon depozitë në emër të shtetases Th. Sula, e cila është hapur në shumën 800.000 lekë, më datë 16.12.2019 deri në datën 16.03.2021, si dhe nga 16.03.2021 - 12.07.2022, në shumën 800.000 lekë. Depozitë e hapur në datë 12.07.2022, në shumën 2.000.000 lekë.

- Nga lëvizja e llogarisë së pagës në Abi Bank, në emër të shtetases Th. Sula, rezulton se shuma 800.000 lekë, ka si burim vetëm të ardhurat nga paga e shtetases Th.Sula, për periudhën 06.02.2017 - 02.04.2019.
- Shuma e transferuar në llogarinë e kursimit në datë 12.07.2022, prej 1.158.000 lekë, ka si burim të ardhurat nga paga 600.000 lekë, të depozituara cash në datat 08.07.2022, në shumën 500.000 lekë dhe në datën 12.07.2022, në shumën 100.000 lekë.

- Për periudhën 02.10.2019 - 08.07.2022, rezulton se është tërhequr nga llogaria shuma rreth 1.350.000 lekë.

37.2 Me informacionin e datës 07.12.2023, subjekti ka sqaruar se: “... *Depozita në momentin e deklaramit ka qenë me gjendje 2.000.000 lekë dhe janë kursime nga pagat e tij, nga paga e bashkëshortes dhe fëmijëve ndër vite. Shuma e deklaruar prej tij në formularin e Deklaratës së Pasurisë, ka qenë lapsus i bërë në shkruajtjen e shifrave*”.

37.3 Të dhënat e llogarisë në emër të shtetases Th. Sula, në Bankën Amerikane të Investimeve (Abi Bank) rezultojnë si më poshtë vijon:

- Mandat arkëtimi datë 08.07.2022, në Abi Bank, nga shtetasja Th. Sula, në shumën 500.000 lekë.
- Mandat arkëtimi datë 12.07.2022, në Abi Bank shtetasja Th. Sula, në shumën 100.000 lekë.
- Mandat transferim fondesh (*urdhër pagesë*), në llogari kursimi datë 12.07.2022, në Abi Bank, nga shtetasja Th. Sula, në shumën 1.185.000 lekë.
- Mandat tërheqje nga llogaria datë 12.07.2022, në Abi Bank, nga Th. Sula, në shumën 980 lekë dhe 30.000 lekë.
- Nxjerrje e llogarisë së kursimit në Abi Bank, në emër të shtetases Th. Sula, datë 12.07.2022. Konfirmohet maturim depozite në datë 28.3.2022, në shumën 811.834 lekë. Kreditim i shumës 1.185.000 lekë, në datë 12.07.2022 dhe kalim i shumës totale 2.000.000 lekë, në depozitë në po të njëjtën datë.
- Formular hapje depozite me afat, në emër të shtetases Th. Sula në Abi Bank, datë 31.10.2023, në shumën 2.500.000 lekë, me afat deri në datë 31.10.2024. Interesi i përfituar në shumën neto 42.615 lekë. Bashkëlidhur kontrata e depozitës bankare datë 31.10.2023 (*pas kohës së dorëzimit të deklaratës*).

37.4 Në informacionin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: “... *Djali i madh i tij, shtetasi L. Sula, që nga mosha 17-18 vjeç, ka punuar si berber nëpër parukeri të ndryshme, por i pa regjistruar dhe për këtë fakt është paguar me para në dorë dhe nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë këto të ardhura. Pavarësisht kësaj, një pjesë e tyre janë dorëzuar në shtëpi dhe janë administruar nga bashkëshortja e subjektit dhe për këtë arsye janë deklaruar si burim për depozitën*”.

Nga hetimi administrativ mbi krijimin e kësaj llogarie bankare rezulton se;

- ✓ **Depozita është krijuar gjatë periudhës 2019 - 2022.**
- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga paga dhe shpërblimet, për periudhën Qershor 1993 - Shkurt 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.262.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhura nga Albsig “*Likuidim dëmi*”, në vitin 2019 janë në shumën totale 1.100.000 lekë. (*trajtuar më poshtë tek rubrika “Të ardhurat”*)**
- ✓ **Shtetasi L. Sula ka dorëzuar dokumentacion mbi llogarinë e tij bankare vetëm për periudhën 06.04.2022-05.04.2024.**

Trupa e Vlerësimit referuar analizës financiare, në përfundim të hetimit konstaton se, në lidhje me krijimin e depozitës bankare, subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e saj.

Pasuria nr.5

38 Një automjet i tipit Opel Vectra A ***V, me nr. shasie W0L00*****.

38.1 DPSHTRR me shkresën nr. *** Prot., datë 14.09.2023, nuk konfirmon automjetin Opel në emër të subjektit dhe të personave të lidhur;

38.2 Në informacionin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: “...*automjeti është blerë në vitin 2007, në vlerën 60.000 lekë dhe është shitur për hekur pasi ishte jashtë funksionit. Disponon kontratën e blerjes së këtij automjeti*”.

38.3 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit, konkretisht:

- Kontratë blerje automjeti nr.*** Rep, nr.*** Kol, datë 16.11.2007, në shumën 60.000 lekë, me palë blerëse subjekti Ilir Sula. Burimi i shumës së blerjes së tij ka qenë nga të ardhurat familjare.
- Faturë shitje nr. *** prot, datë 15.10.2024, mbi automjetin Opel, vërtetuar nëpërmjet nr. të shasisë W0L00*****, për skrap hekuri në shumën 39.000 lekë.

Në përfundim të hetimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, për sa i përket blerjes dhe shites së automjetit. Automjeti nuk konfirmohet nga DPSHTRR.**

✓ **Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.**

Pasuria nr. 6

39 Automjet Volkswagen, me targë AA***TJ, dhuruar djalit të subjektit, shtetasit L. Sula nga kushëriri i tij, shtetasi M. Sula. Ky mjet është shitur për hekur pas një aksidenti, në shumën 1.000 euro dhe është çregjistruar.

39.1 DPSHTRR me shkresën nr. *** Prot., datë 14.09.2023, konfirmon se shtetasi L. Sula, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA***TJ, me status “*çregjistrim i përkohshëm*”.

39.2 Dokumente bashkëlidhur;

- Vërtetim për çregjistrim mjeti datë 13.12.2019, automjet Volkswagen me targë AA***TJ, në emër të shtetasit L. Sula.

- Faturë zhdoganimi e datës 19.02.2018, nga shtetasi L. Sula, për automjetin Volkswagen Golf. Vlera e automjetit 1 euro. Shuma e detyrimeve doganore 74.338 lekë.
- Leje qarkullimi e Mbretërisë së Bashkuar, në emër të shtetasit L. Sula, e datës 23.01.2018.
- Automjet Volkswagen Golf regjistruar për herë të parë në datë 01.03.2004.
- Deklaratë jo noteriale, e shtetasit M. Sula e datës 05.06.2024, bashkëngjitur informacionit të dorëzuar nga subjekti me datë 19.12.2024.

Në përfundim të hetimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR.**
- ✓ **Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.**

40 DETYRIME FINANCIARE

40.1 Subjekti deklaron se nuk ka kredi, por ka një detyrim financiar ndaj personave juridikë mbi pagimin e taksave të automjetit me targë TR****J, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë, të cilin e ka blerë për pjesë këmbimi.

40.2 DPSHTRR me shkresën Nr.***, datës 14.09.2023, nuk konfirmon automjetin e deklaruar.

40.3 Me inventarin e datës 07.12.2023, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se automjeti është blerë me kontratë blerje dhe është shitur për pjesë këmbimi.

40.4 Me inventarin e datës 14.12.2023, subjekti ka dorëzuar dokumente justifikues:

- Kontratë blerje automjeti nr.*** Rep, nr. *** Kol, datë 30.12.2014, ku palë blerëse është subjekti Ilir Sula. Automjet mercedez Benz me targë TR *** J, vit prodhimi 1991, në shumën 150.000 lekë.

40.5 Bashkëngjitur informacionit të datës 19.12.2024, subjekti ka dorëzuar:

- Faturë tatimore nr. ***, datë 12.09.2024, mbi shitjen e automjetit me targë TR *** J, për pjesë këmbimi në vlerën 40.000 lekë.
- Printim të dhënash nga sistemi e-gjoba, për mjetin TR *** J, i cili nuk figuron në emër të subjektit.

✓ **Trupa e Vlerësimit pas analizimit të të dhënave, si dhe nga verifikimi kryer në sistemin e-gjoba, konstatoi se aktualisht automjeti me targë TR****J, nuk është në pronësi të subjektit dhe nuk ka detyrime financiare.**

41 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Në proces-verbalin e datës 07.11.2023, subjekti ka deklaruar se: "...ka filluar punë në strukturat e Policisë së Shtetit në vitin 1993 deri në 2018, ku është larguar me kërkesën e tij. Ka punuar si drejtues teknik tek "*Firma *****" dhe tek "*Hotel *****", për periudhën nga mesi i vitit 2018 deri në shkurt të vitit 2023, ku është rikthyer në Strukturat e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Totali i të ardhurave rezulton në shumën 20.634.221 lekë.

41.1 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin justifikues si vijon:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të subjektit Ilir Sula, për periudhën 2005 – 2022, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën maj 2005 - Maj 2020.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, më datë 07.03.2023, ku Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën Qershor 2020 - Shkurt 2023.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 10.03.2023, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën Tetor 2011 - Tetor 2012 dhe Qershor 2018 - Maj 2020.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar të datës 07.03.2023, nga ISSH ku konfirmohen kontributet e derdhura për subjektin Ilir Sula, për periudhën Janar 2012 - Tetor 2017 nga Policia e Shtetit, për periudhën Qershor 2018 - Nëntor 2018, nga subjekti "*****" dhe për periudhën Dhjetor 2018 - Dhjetor 2022, nga subjekti "*****".
- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. **** Prot., datë 04.09.2023, konfirmon të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën Prill 2005 - Nëntor 2011; Tetor 2012 - Nëntor 2017 dhe Maj 2018 - Maj 2020, në shumën totale 13.510.523 lekë. Të ardhurat nga paga e bashkëshortes, për periudhën Dhjetor 2007 - Gusht 2009, në shumën 351.637 lekë (trajtuar në seksionin e të ardhurave të bashkëshortes më poshtë)
- BKT me shkresën nr. **** Prot., datë 13.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Ilir Sula, për periudhën 03.11.2011 - 26.03.2021.
- Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën Tetor 2011 - Tetor 2012, në shumën 918.675 lekë dhe për periudhën Qershor 2018 - Maj 2020, në shumën 841.825 leke. Të ardhura nga Albsig "*Likuidim Dëmi*", në datë 06.12.2019, në shumën 800.000 lekë dhe në datë 20.12.2019, në shumën 300.000 lekë.
- Tirana Bank me shkresën nr. **** Prot., datë 06.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Ilir Sula, me balancë në datë 10.03.2023, shumën 37 lekë.
- Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën Qershor 2020 - Shkurt 2023, në shumën totale 4.340.479 lekë.
- ISSH me shkresën nr. **** Prot., datë 06.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Ilir Sula nga Drejtoria e Policisë, për periudhën Janar 2012 - Tetor 2017, nga "*M***A****" për periudhën Qershor 2018 - Nëntor 2018, si dhe nga "*K*** Hotels & Tower*", për periudhën Dhjetor 2018 - Dhjetor 2022 dhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për periudhën Shkurt 2023 - Korrik 2023.
- ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. **** Prot., datë 12.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipt i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

41.2 Me inventarin nr. extra Prot., datë 23.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim nr. ***, datë 22.11.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës. Konfirmohen të ardhurat nga paga dhe shpërblimet për periudhën 01.06.1993 - 28.02.1995, në shumën totale neto 189.618 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar për Ilir Sula, për periudhën 03.08.1996 - 27.03.1997. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat janë derdhur kontributet në shumën 116.870 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar për Ilir Sula, për periudhën 12.12.2001 - 31.1.2002. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat janë derdhur kontributet në shumën 42.476 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar për Ilir Sula, për periudhën Dhjetor 2003 - Maj 2004. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat janë derdhur kontributet në shumën 301.242 lekë.
- Vërtetim nr. TRF****, datë 14.11.2019, për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi. Konfirmohet se mjeti me targë AA****TJ, është hequr nga qarkullimi i përkohshëm, nga data 14.11.2019 deri në datën e ri-futjes në qarkullim.

41.3 Të ardhura nga Albsig “*likuidim dëmi*” në vitin 2019, në shumën totale 1.100.000 lekë. Në lidhje me justifikimin e këtyre të ardhurave, subjekti i vlerësimit ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- Akt marrëveshje për ndërmjetësim, e protokolluar me nr.*** prot, datë 22.11.2019, me ndërmjetësuese shtetasja A. E dhe palë ndërmjetësuese Albsig sh.a, L. Sula, I. Sula, R. Sula dhe shtetasi D. S, “*Shpërblim dëmi shëndetësor dhe material*”. Është kërkuar dëmshpërblim për shtetasin D. S në shumën 150.000 lekë, për I. Sula në shumën 140.000 lekë, për R. Sula në shumën 660.000 lekë dhe për dëmet materiale të shkaktuara mjetit me targë AA****TJ (në pronësi të djalit të subjektit, shtetasit L. Sula, në shumën 300.000 lekë).
- Shuma e dëmshpërblimit total, për dëmin shëndetësor shkaktuar shtetasve për I. Sula në shumën 140.000 lekë, për R. Sula në shumën 660.000 lekë dhe për dëmet materiale të shkaktuara mjetit me targë AA****TJ (në pronësi të djalit të subjektit, shtetasit L. Sula, në shumën 300.000 lekë do kalojnë në llogarinë e Ilir Sula në BKT.
- Shkresë nr. ***, datës 14.09.2023, nga DPSHTRR, konfirmon se shtetasi L. Sula, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA752TJ, me status “çregjistrim i përkohshëm”.
- Vërtetim nr.***, datës 14.11.2019, për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi. Konfirmohet se mjeti në fjalë, është hequr nga qarkullimi i përkohshëm, nga data 14.11.2019 deri në datën e ri futjes në qarkullim.

Në përfundim të hetimit mbi të ardhurat e subjektit të vlerësimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga pagat dhe shpërblimet për periudhën 1993 -2023 janë në vlerën totale 20.262.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat nga Albsig për likuidim dëmi, janë në shumën totale 1.100.000 lekë.**
- ✓ **Përputhet deklarimi me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti.**

42 **SHPENZIME TË DEKLARUESHME**

Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë si më poshtë:

- Shpenzime për energji elektrike, Janar 2022 deri në 30.12.2022, në shumën 104.427 lekë.
- Shpenzime për ujësjellësin, Janar 2022 deri në 30.12.2022, në shumën 44.286 lekë.
- Shpenzime telefoni celular, për vitin 2022, në shumën 12.000 lekë.

Bashkëlidhur:

- Faturë Tatimore nga OSHEE, për pagesën e detyrimeve për kontratën nr.*** në emër të subjektit Ilir Sula, për periudhën Nëntor 2017 - Shkurt 2023. Shuma e paguar për vitin 2022 (Janar - Dhjetor), në shumën 104.422 lekë.

43 FSHU me shkresën nr. *** Prot., datë 11.09.2023, konfirmon një kontratë furnizimi me energji elektrike, në emër të subjektit Ilir Isuf Sula, me nr. kontrate ****, në instancën Tiranë. Shuma e paguar për vitin 2022 (Janar - Dhjetor 2022), në shumën 104.422 lekë.

44 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** Prot., datë 29.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

45 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Durrës, me shkresën nr. *** Prot., datë 12.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

46 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Fier, me shkresën nr. *** Prot., datë 06.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

47 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Elbasan, me shkresën nr. *** Prot., datë 11.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

48 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. *** Prot., datë 15.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

49 10 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

50 Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr. *** prot, datë 24.11.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

51 One Albania sh.a, me shkresën nr. *** Prot., datë 15.09.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.

52 Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. ***Prot., datë 12.09.2023, nuk konfirmon kontrata te lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

53 Abissnet sh.a, me shkresën nr. ***, datë 18.09.2023, nuk konfirmon kontrata te lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

54 Digicom sh.a, me shkresën nr. ***, datë 11.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

55 Me inventarin nr.extra Prot., datë 23.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Kërkesë drejtuar OSHEE- Group dhe FSHU nga Ilir Sula, për marrje informacioni lidhur me numrin e kontratave në emrin e tij dhe personave të lidhur me të, pasi ai dhe familjarët e tij, kanë vetëm një kontratë me OSHEE, me nr. TR*****.
- Kopje të faqes së parë të librezës me FSHU, në emër të subjektit Ilir Sula, me nr. kontrate TR3S*****.
- Kopje të faqes së parë të librezës me UKT, në emër të shtetasit Ilir Sula, me nr. kontrate P*****.
- Kërkim on-line, datë 11.08.2023, për abonentin Ilir Sula. Konfirmohet se në emër të Ilir Sula/Sulaj, identifikohen 107 persona. Me numër personal H*****S, identifikohet vetëm një person (që është subjekti deklarues).

56 Me inventarin nr.extra Prot., datë 07.12.2023 subjekti ka sqaruar se: “...Shpenzimet për energji elektrike nga Janari 2022 deri në 30.12.2022 janë në shumën 104.427 lekë, për kontratën me nr.TR3S*****. Shpenzimet për ujësjellësin, për kontratën nr. P*****, nga Janari 2022 deri në 30.12.2022 janë në shumën 44.286 lekë. Ka sqaruar se të gjitha kontratat e tjera të energjisë dhe te ujësjellës kanalizimeve nuk janë në adresën e tij, pasi ju përkasin shtetasve të tjerë, të cilët nuk i njeh. Gjithashtu në lidhje me dy kontratat e tij, nuk ka asnjë detyrim pa shlyer.

57 Me inventarin nr.extra Prot. datë 14.12.2023 subjekti ka dorëzuar:

- Kthim përgjigje nga FSHU, nr.*** prot, datë 05.12.2023, informon mbi të dhënat e konstatuara mbi abonentin Ilir Isuf Sula dhe personat e lidhur me të.
- Certifikatë e përbërjes familjare të Ilir Sula, datë 21.11.2023, e përbërë nga 6 anëtarë (Ilir Sula, Th. Sula, L. Sula, I. Sula, R. Sula dhe A. Pajollari).
- Kopje e librezës me nr. kontrate TR3S***** , në emër të shtetasit Ilir Sula, ku konfirmohen pagesat e kryera për vitin 2023.
- Kopje të faqes së parë të librezës me FSHU, në emër të shtetasit Ilir Sula, me nr. kontrate TR3S***** , si dhe pagesat e kryera për vitin 2023 (Janar - Tetor 2023).
- Kopje të faqes së parë të librezës me UKT, në emër të shtetasit Ilir Sula me nr. kontrate P***** , si dhe pagesat e kryera për vitin 2023 (Janar - Tetor 2023).
- Formë aplikimi për faturë analitike nga Vodafone Albania, datë 12.12.2023, për shpenzimet e kryera për numrin e telefonit celularë 069***** , në emër të Ilir Sula. (numër i cili nuk konfirmohet nga përgjigjja e ardhur nga Vodafone Albania).

58 Në proces verbalin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: “...në lidhje me shpenzimet e telefonit nuk ka arritur të marrë vërtetim për numrat e celularit në emrin e tij dhe të personave të lidhur, si dhe pagesat e kryera për secilin numër. Deklaroi se bashkëshortja e tij ka numrin e telefonit 068*****, ai ka numrin e telefonit 069*****, djali R. Sula ka numrin 069*****, ndërsa fëmijët në emigracion kanë numra të huaj. Sqaroi gjithashtu se nuk ka arritur të sigurojë as përgjigje nga UK Tiranë, Durrës, Fier dhe Elbasan, Për kontratat e konfirmuara nga ana e tyre në emrin e tij dhe të djemve të tij, por deklaroi me përgjegjësi të plotë, se ai ka vetëm një kontratë me OSHEE dhe një me UK, të cilat i përkasin objektit që zotëron. Po ashtu edhe djemtë e tij nuk kanë asnjë kontratë në emrin e tyre”.

Bashkëlidhur

- Detajet e pagesës së konsumatorit nga sistemi i OSHEE, për kontratën nr. kontrate TR3S*****, në emër shtetasit Ilir Isuf Sula.
 - Faturat tatimore FSHU të Ilir Sula me nr. kontratë TR3S*****, për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Shuma e paguar në total 104.422 lekë.
 - Faturë tatimore shitje të UKK në emër të shtetasit Ilir Sula me nr. kontrate P*****, për periudhën Janar - Dhjetor 2022. Shuma e paguar në total 42.850 lekë.
- 59 Me e-mailin e datës 18.01.2024, subjekti ka dorëzuar:
- Kërkesë për kthim përgjigje, e muajit Janar 2024, drejtuar Drejtorisë së Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Vlorë.
- 60 Me e-mail-in e datës 07.02.2024, subjekti ka dorëzuar:
- Kthim përgjigje nr. ***, datë 30.01.2024, nga UK Durrës, ku konfirmohet se nga verifikimi i të dhënave për klientët që i përkasin kontratat e konfirmuara nga ana e tyre është arritur në konkluzionin që nuk përputhen me gjeneralitetet e kërkuar të shkresës.
 - Kthim përgjigje nr.*** prot, datë 11.09.2023, nga UK Vlorë, ku konfirmohet se kontrata me nr. ****, në emër të L. Sula (pa atësi dhe ID), me numër klienti nr.****, zona Komuna Qendër, rezulton të ketë 2*716 lekë detyrime. Përsa i përket shtetasve të tjerë Ilir Sula, Th. Sula, I. Sula, R. Sula dhe A. Pajollari, sipas kontrollit në sistemin elektronik, nuk rezultojnë të kenë kontrata në emrin e tyre.
 - Kthim përgjigje nr.***prot, datë 26.01.2024, nga UK Vlorë, ku konfirmohet se pas verifikimeve në terren është konstatuar se klienti me nr. ****, e ka atësinë Xh***, pra rrjedhimisht, nuk është i njëjti person.
 - Kthim përgjigje nr.***, datë 30.01. 2024, nga UK Elbasan. Konfirmohet se nuk disponojnë kontrata shkresore midis abonentit dhe shoqërisë, për këtë rast dhe nuk e vërtetojnë se kërkuar, është abonent i mbajtës i kontratave të konfirmuara.
 - Kthim përgjigje nr.***prot, datë 31.01.2024, nga UK Fier. Konfirmohet se në sistemin e faturimit Al Billing, nuk rezulton të ketë kontratë në emër të Ilir Isuf, N. Sula, me ID H*****S.

Në përfundim të hetimit mbi shpenzimet e subjektit të vlerësimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

✓ **Shpenzimet e deklaruar për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, në total për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë rreth 193.000 lekë.**

✓ **Trupa e Vlerësimit referuar analizës financiare, në përfundim të hetimit konstaton se, në lidhje me shpenzimet e deklaruar, subjekti i vlerësimit ka pasur mundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve.**

61 SHPENZIME PËR UDHËTIMET PRIVATE, PERSONALE APO TË PERSONAVE TË LIDHUR, JASHTË TERRITORIT SHQIPTAR GJATË 3 VITEVE TË FUNDIT (KALENDARIKE), DUKE SPECIFIKUAR SHTETIN, VENDIN E QËNDRIMIT, KOHËZGJATJEN DHE SHPENZIMET E PËRBALLUARA PËR PERIUDHËN 01.01.2020-31.12.2022.

61.1 Subjekti ka deklaruar lëvizjet jashtë vendit dhe shpenzimet për udhëtimet, për veten dhe personat e lidhur me të, si vijon;

- I biri, shtetasi L. Sula ka tre lëvizje hyrje - dalje në Angli, nga data 01.01.2020 31.12.2022 Shpenzimet për bileta janë 1.500 paund.
- I biri, shtetasi I. Sula ka një lëvizje jashtë vendit për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, në USA dhe bileta ka kushtuar 1.100 \$.
- I biri, shtetasi R. Sula ka një lëvizje hyrje-dalje në Mal të Zi, me afat qëndrimi një ditor. Vlera e shpenzuar ka qenë 50 euro.
- Nusja e djalit, shtetasja A. P., ka 4 dalje dhe 3 hyrje për periudhën 2020 - 2022. Për vlerën e shpenzimeve nuk ka informacion.

61.2 Burimi i shumave të shpenzuara kanë qenë nga të ardhurat e tyre.

61.3 Në informacionin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: “...fëmijët kanë udhëtuar në drejtim të shteteve të tyre, ku jetojnë si emigrantë të ligjshëm, dhe nuk ka informacion të saktë për shpenzimet e kryera prej tyre. Por janë vetëm shpenzimet e biletave. Ai dhe bashkëshortja, gjatë periudhës 2020-2022, nuk kanë asnjë udhëtim jashtë vendit. Ndërsa djali i tyre i vogël R. Sula ka dalë vetëm një herë me klasën, ekskursion në Malin e Zi.”

Në përfundim të hetimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje-daljeve nga Republika e Shqipërisë, gjatë periudhës 2020-2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.**

62 SHPENZIMET PËR ARSIMIN E FËMIJËVE, MADHORË APO TË MITUR, APO TË PERSONAVE TË LIDHUR, DUKE DEKLARUAR FILLIMIN, LLOJIN E INSTITUCIONIT ARSIMOR, EMRIN E INSTITUCIONIT, PAGESAT VJETORE, SI DHE KOHËZGJATJEN E STUDIMEVE.

Pagesë shkolle vjetore për djalin R. Sula, në Canadian Institute of Technology, për vitin 2021, paguar më datë 28.10.2021, si dhe për vitin 2022, paguar më datë 18.02.2022, shuma 2.500 Euro.

62.1 Me informacionin e datës 07.12.2023, subjekti ka shpjeguar se: “...për dy vitet e para të studimit të djalit të tij, shtetasit R. Sula, në Kolegjin Universitar ‘Instituti Kanadez i Teknologjisë’,

është paguar shuma 2.450 euro, për secilin vit. Studimet e tjera nga fëmijët janë kryer në shkolla publike në gjimnazin ‘Gramoz Palushi’, Babrru, Tiranë”.

Bashkëlidhur:

- Vërtetim pagese nga “Canadian Institute of Technology (CIT)”, datë 23.11.2023, ku konfirmohet pagesa e kryer nga shtetasi R. Sula, për vitin e parë akademik 2021-2022, në shumën 2.450 euro dhe për vitin e dytë akademik 2022-2023, në shumën 2.450 euro (total 4.900 euro)
- Vërtetim i datës 16.11.2023, nga Gjimnazi “Gramoz Palushi” Babrru, ku konfirmohet se shtetasi R. Sula, ka mbaruar gjimnazin me kohë të plotë, në vitin shkollor 2020-2021.
- Vërtetim i datës 16.11.2023, nga Gjimnazi “Gramoz Palushi” Babrru, ku konfirmohet se shtetasi I. Sula, ka mbaruar gjimnazin me kohë të plotë në vitin shkollor 2018-2019.
- Vërtetim i datës 16.11.2023, nga Gjimnazi “Gramoz Palushi” Babrru, ku konfirmohet se shtetasi L. Sula, ka mbaruar gjimnazin me kohë të plotë, në vitin shkollor 2016-2017.
- Vërtetim i datës 12.12.2023, nga shkolla 9 vjeçare “Azem Hajdari”, Paskuqan, Tiranë. Konfirmohet se shtetasi L. Sula, ka mbaruar klasën e IX, në vitin shkollor 2012-2013.
- Dëftesë lirimi në emër të shtetasit I. Sula, nga shkolla 9 vjeçare “Azem Hajdari”, Paskuqan, Tiranë, lëshuar në dt. 14.07.2016.

Në përfundim të hetimit nga Trupa e Vlerësimit, rezultoi se:

✓ Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës 2021 deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 4.900 Euro, e konvertuar rreth 559.000 lekë.

✓ Trupa e Vlerësimit referuar analizës financiare, në përfundim të hetimit konstaton se, në lidhje me shpenzimet e deklaruara, subjekti i vlerësimit ka pasur mundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve të deklaruara më sipër.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – TH. SULA

Pasuria nr.1

63 Pasuri e paluajtshme, truall me sip. 437.55 m2 dhe ndërtesë me sip. 145.85 m2, ku pjesa më e madhe e përqindjes në banesë ka qenë e pjesëtareve të tjerë të familjes, të cilët ma kanë dhuruar me akt-dhurimi. Pasuria ndodhet z.k.***** Tiranë. Vit i krijimit 2001 e në vazhdim ndër vite, e cila akoma nuk është përfunduar. Vlera 16.369.080 lekë.

Trajtuar më sipër në seksionin nr. 31

Pasuria nr.2

64. Automjet tip Mercedes Benz, me targë AB***GC, viti 2006, në vlerën 2.200 Euro. Burimi i krijimit: Nga shitja e automjetit me targë AB***GD, Mercedes Benz, në vlerën 2.200 euro, në datë 26.04.2022.

Zotëron: 100%.

63.1 Me shkresën nr. ***, datë 14.09.2023, konfirmohet nga DPSHTRR, se shtetasja Th. Sula ka pasur të regjistruar mjetin me targë AB***GC dhe AB***GD.

Dokumentet e administruara në funksion të hetimit:

- Kontratë blerje automjeti e datës 30.03.2022, pale blerëse shtetasen Th. Sula, për automjetin Mercedes Benz A160CDI, në shumën 1.800 Euro. (*regjistruar me targë AA***GD*)
- Kontratë shitje automjeti e datës 26.04.2022, palë shitëse shtetasja Th. Sula, për automjetin Mercedes Benz, me targë A***GD, në shumën 2.200 Euro.
- Kontratë blerje automjeti me targë AB***GC, e datës 19.04.2022, në shumën 3.200 euro palë blerëse shtetasja Th. Sula.
- Kontratë shitje automjeti me targë AB***GC e datës 05.06.2023, në shumën 1.000 euro palë shitëse shtetasja Th. Sula. Revokim kontrate.
- Revokim Aktesh e të tjera (*zgjidhje kontrate*), ku shfuqizohet kontrata e datës 05.06.2023, për shitje mjeti.
- Kontratë shitje automjeti e datës 24.08.2023, palë shitëse shtetasja Th. Sula, për automjetin Mercedes Benz, me targë A***GC, në shumën 1.000 euro.

Nga kontrolli dhe vlerësimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit, bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit, konstatohet se:

✓ **Bashkëshortja e subjektit, Th. Sula ka blerë automjetin me targë AB*** GC më datë 30.03.2022, në vlerën 1.800 Euro.**

✓ **Burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit me targë A***GD, në shumën 2.200 Euro.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur DPSHTRR.**

✓ **Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.**

Pasuria nr.3

64 Automjet mercedes benz me targa LU***** C, viti i prodhimit 2000, vlere e blerjes 400.000 lekë, të cilën e ka shitur 70.000 lekë, për hekur.
Zotëron: 100%.

64.1 DPSHTRR me shkresën nr. ***, datës 14.09.2023, nuk konfirmon automjetin e deklaruar në emër të shtetasës Th. Sula.

64.2 Subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: “...burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë nga të ardhurat nga pagat dhe nga shitje mjeti.”

64.3 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim kontratën e blerjes së automjetit me targë LU**** C, në shumën 400.000 lekë, me palë blerëse shtetasja Th. Sula.

64.4 Më datë 19.12.2024, subjekti ka dorëzuar faturë tatimore shitje për mjetin me targë LU**** C, për pjesë këmbimi në vlerën 70.000 lekë.

Nga kontrolli dhe vlerësimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit, konstatohet se:

✓ Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se, mjeti Mercedes Benz, me targë L****C, është blerë në vitin 2010, në shumën 400.000 lekë, me burim nga të ardhurat familjare. Sipas faturës tatimore të shitjes, automjeti është shitur për pjesë këmbimi në vlerën 70.000 lekë.

✓ Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.

Pasuria nr.4

65 Automjet i llojit Ford, viti i prodhimit 1988, me targë TR*****D.

Vlera: 80'000 lekë.

Zotëron: 100%.

65.1 DPSHTRR me shkresën nr. ***, datë 14.09.2023, nuk konfirmon automjetin e deklaruar në emër të shtetasës Th. Sula.

65.2 Subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: *“...burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë nga të ardhurat nga pagat dhe nga shitje mjeti.”*

65.3 Referuar kontratës së shit-blerjes, datë 21.02.2007, ku blerës është shtetasja Th. Sula, automjeti është blerë në vlerën 80.000 lekë.

65.4 Bashkëlidhur informacionit të datës 19.12.2024, subjekti ka dorëzuar:

- Faturë shitje, datë 16.10.2024, të mjetit me targë TR*****D, në shumën 42.000 lekë.

Nga kontrolli dhe vlerësimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit, konstatohet se:

✓ Bazuar në deklarimet e subjektit dhe dokumentet justifikuese të administruara, rezulton se automjeti Ford, me targë TR*****D, është blerë në vlerën 80.000 lekë, me kontratë të datës 21.02.2007 dhe është shitur në vlerën 42.000 lekë.

✓ DPSHTRR nuk konfirmon automjetin me targë TR*****D, në emër të shtetasës Th. Sula.

Pasuria nr.5

66 Automjet marka Daimler Chrysler, vit i prodhimit 2004, me targa AA*** JF, i cili është shitur për hekur në shumën 80.000 lekë.

Zotëron: 100%.

66.1 DPSHTRR me shkresën nr.***, datë 14.09.2023, konfirmon se shtetasja Th. Sula, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA***JF.

66.2 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë blerje automjeti nr. ***rep, nr. *** kol, datë 29.5.2018, me targë AA*** JF, në shumën 2.000 Euro, ku palë blerëse është shtetasja Th. Sula.
- Kontratë shitje automjeti nr. ***rep, nr. *** kol, datë 01.04.2022, me palë shitëse Th. Sula, për automjetin me targë AA*** JF, në shumën 1.000 euro.
- Në proces verbalin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: *“...nuk ka mbajtur mend shumën e saktë të shitjes së këtij automjeti, për këtë arsye në deklaratimet e më mëparshme ka raportuar gabim shumën e shitjes së mjetit”*.

Në përfundim të hetimit Trupa e Vlerësimit, konstaton se:

✓ **Bazuar në deklarinimin e subjektit, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se, automjeti Daimler Chrysler, me targë AA*** JF, është blerë në vitin 2018, në shumën 2.000 euro dhe shitur në vitin 2022, në shumën 1.000 euro.**

67 **DEKLARIM I TË ARDHURAVE TË SHTETASES TH. SULA**

Të ardhura të krijuara nga puna si mjeke Pneumologe, sipas tabelës nga Abi Bank dhe Credins Bank, në vite, në shumën totale 6.818.652 lekë.

Konkretisht; 2005 - 2007 shuma 0 lekë, 2008 - 218.921 lekë; viti 2009 - 117.532 lekë; 2010 - 2013-shuma 0 lekë; 2014 - 562.470 lekë; 2015 - 585.175 lekë; 2016 - 581.389 lekë; 2017 - 584.368 lekë; 2018 - 662.648 lekë; 2019 - 697.084 lekë; 2020 - 741.244 lekë; 2021 - 984.661 lekë; 2022 - 899.326 lekë; deri në datë 02.03.2023, në shumën 183.834 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

67.1 Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të shtetases Th. Sula, për periudhën 01.01.2014 - 06.03.2023, konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën Dhjetor 2013 - Tetor 2022.

67.2 Nxjerrje llogarie nga ABI Bank, për periudhën 30.12.2016 - 27.02.2023. Konfirmohet kreditimi i pagës Janar 2016 - Janar 2023.

67.3 Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** Prot., datë 04.09.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për shtetasen Th. Sula, për periudhën Dhjetor 2007 - Shtator 2011, në shumën totale 743.746 lekë nga të cilat, periudha Dhjetor 2007 - Gusht 2009, në shumën 351.637 lekë, kredituar në llogarinë e subjektit; dhe shtator 2009 - Shtator 2011 në shumën 392.109 lekë, kredituar në llogarinë e saj.

67.4 BKT me shkresën nr. *** Prot., datë 13.09.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Th. Sula, për periudhën 02.12.2011 - 28.01.2013. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën Nëntor 2011 - Qershor 2012, në shumën 148.214 lekë.

67.5 Tirana Bank me e-mail-in e datës 02.11.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për shtetasen Th. Sula për periudhën Korrik - Dhjetor 2006, në shumën 103.572 lekë.

67.6 ABI Bank me shkresën nr. *** Prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetases Th. Sula, me balancë në datë 10.03.2023, në shumën 70.517 lekë. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën Janar 2017 - Shkurt 2023, në shumën 4.156.876 lekë.

67.7 Credins Bank me shkresën nr. *** Prot., datë 10.10.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Th. Sula, për periudhën Dhjetor 2013 - Shkurt 2023. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën Nëntor 2013 - Shkurt 2023, në shumën totale 2.382.634 lekë.

67.8 Union Bank me shkresën nr. *** Prot., datë 12.09.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Th. Sula, për periudhën Gusht 2012 - Dhjetor 2013. Konfirmohet kreditimi i pagave për periudhën Korrik 2012 - Tetor 2013, në shumën 701.232 lekë.

67.9 ISSH me shkresën nr. *** Prot., datë 06.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për shtetasen Th. Sula nga Drejtoria e Policisë, për periudhën Janar 2012 - Qershor 2012, nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal për periudhën Korrik 2012 - Korrik 2023.

67.10 Me inventarin nr.extra Prot., datë 23.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim për bazën e vlerësuar për shtetasen Th. Sula për periudhën Janar - Prill 2004, nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë. Konfirmohet se është trajtuar me transferta bashkëshorteje dhe ka realizuar të ardhurat mbi të cilën janë derdhur kontributet në shumën 40.240 lekë.

67.11 Me inventarin nr.extra Prot., datë 07.12.2023, subjekti ka sqaruar m se: "...bashkëshortja e tij ka filluar punë në vitin 1995, si mjeke dhe për këtë fakt ka paraqitur dokumentet si më poshtë:

- Librezë pune në emër të shtetases Th. Rexhmati (Sula), nr. regjistri themeltar ***. Konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 01.12.1995 e në vazhdim.
- Librezë Kontributesh për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore në emër të shtetases Th. Sula për periudhën 2012 - Janar 2020.
- Vërtetim nr. *** Prot., datë 19.03.2003 nga Drejtoria e Shëndetit Publik Kukës. Konfirmohet se shtetasja Th. Sula, është në marrëdhënie pune për periudhën 01.12.1995 e në vazhdim.

- Vërtetim nr.*** Prot., datë 06.02.2018, nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë. Konfirmohet se shtetasja Th. Sula, është punonjëse pranë Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë që nga data 02.07.2012, e në vazhdim. Paguhet me pagë neto mujore 50.405 lekë.
- Vërtetim nr. *** Prot., datë 04.05.2023 nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë. Konfirmohet se shtetasja Th. Sula, është punonjëse pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, që nga viti 2012 e në vazhdim. Paguhet me pagë neto mujore 73.979 lekë.
- Tabela e të ardhurave për periudhën 1996 - 2002 (e pa vulosur). Konfirmohen të ardhurat në shumën neto 1.654.592 lekë.

67.12 Me inventarin nr.extra Prot., datë 14.12.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim për pagën kalimtare për shtetasen Th. Sula, për periudhën 05.10.2011 - 30.06.2012. Të ardhurat e përfituara në shumën totale 148.214 lekë. Për periudhën Maj - Dhjetor 2000, në shumën 139.978 lekë.

67.13 Në proces verbalin e datës 15.01.2024 subjekti ka sqaruar se: “...të ardhurat e llogaritura nga ana e tij, janë bazuar tek statement bankare dhe dokumentacionit të të ardhurave të cilat janë paraqitur nga ana e tij”.

67.14 Subjekti ka bashkëlidhur vërtetim nr. *** Prot., datë 06.12.2023, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Kukës, ku konfirmohen të ardhurat për shtetasen Th. Sula për periudhën 01.12.1995 deri në 31.12.2002, në shumën neto 1.654.592 lekë.

- Të ardhurat nga paga e bashkëshortes, për periudhën Dhjetor 1995 - Shkurt 2023, rezultojnë në shumën rreth 9.931.000 lekë.

67.15 Me inventarin e datë 07.12.2023, subjekti ka deklaruar se: “...ka qenë harresë nga ana e bashkëshortes, mos deklarimi i fondit të pensionit në shumën 21.953 lekë”.

Në përfundim të hetimit Trupa e Vlerësimit, konstaton se:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, si dhe në korrespondencën e administruar, Trupa e Vlerësimit konstaton se të ardhurat nga paga për shtetasen Th. Sula, për periudhën Dhjetor 1995 - Shkurt 2023, rezultojnë në shumën rreth 9.931.000 lekë.

DEKLARIMI I NËNËS – N. SULA

DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr.1

68 Pasuri e paluajtshme shtëpi, me sipërfaqe truall 437.55 m2 dhe ndërtesë 145.85 m2, Nr. pasurie 397/30, Zk. ***.

Zotëron: 25%.

68.1 Sqarime me shkrim nga subjekti, ku ka deklaruar se është e njëjta pasuri e lëshuar me certifikatë në emrin e tij, me nr. pasurie *****, Zk. ****, me sip. totale 431.55 m² truall dhe ndërtesë 145.85 m², lëshuar në datë 06.05.2021, ku i gjithë objekti është në pronësinë e tij.

Trajtuar më sipër në seksionin 31.

Pasuria nr. 2

69 Kam me pjesëtarët e tjerë të familjes dhe një ndërtesë të vogël njëkatëshe 25 m², të pandarë, në proces legalizimi.

Burimi i të ardhurave: Nga kontributi i pjesëtarëve të familjes nga pagat dhe kursimet ndër vite.

Trajtuar më sipër në seksionin 34.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

70 Pensioniste, filluar me datë 28.06.1991, vlera e pensionit 11.726 lekë. E përlllogaritur për 22 vjet shuma rreth 257.972 lekë.

70.1 Të ardhurat nga pensioni i nënës, për periudhën Qershor 1991 - Shkurt 2023, rezultojnë në shumën rreth 4.503.000 lekë.

71 Me inventarin e datës 07.12.2023, subjekti ka vënë në dispozicion të hetimit dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë vdekje (nga akti) datë 22.11.2023. Konfirmohet se shtetasja N. Sula ka ndërruar jetë në datë 13.09.2023.

Në përfundim të hetimit Trupa e Vlerësimit, konstaton se:

✓ **Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, si dhe në korrespondencën e administruar, Trupa e Vlerësimit konstaton se të ardhurat nga pensioni për shtetasen N. Sula, për periudhën Qershor 1991 - Shkurt 2023, rezultojnë në shumën rreth 4'503'000 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT – L. SULA

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

72 Jam në emigracion në Angli, i vetëpunësuar, me profesion MENS Barbers LTD, me adresë: "*****" nga periudha 01.06.2022 e në vazhdim.

Të ardhurat në shumën rreth 20.200 paund, para bërjes së taksave.

72.1 Me inventarin e datës 07.12.2023, subjekti sqaron se: “...djali i tij, shtetasi L. Sula ka ikur në emigracion në datë 27.09.2018 dhe është kthyer në datë 11.10.2018. Më pas ka ikur në Angli në datë 20.10.2020, ku vazhdon dhe aktualisht është me letra të rregullta ku punon si “berber” i vetëpunësuar. Shpenzimet vjetore të djalit shkojnë rreth 12 - 14.000 paund në vit. Llogaria e të ardhurave dhe shpenzimeve, që përfundon në datë 05.04.2023, të subjektit “T/A Berber”, në emër të shtetasit L. Sula. Fitimi neto i vitit, në shumën 23.674 paund”.

Bashkangjitur:

- Formulari i llogaritjes së taksave vjetore datë 06.12.2023, në emër të shtetasit L. Sula.
- Formulari i kthimit të taksave on-line për vitin 2023.
- Llogaria e të ardhurave dhe shpenzimeve (në gjuhën angleze), për vitin, që përfundon në datë 05.04.2023, të subjektit “T/A Berber” në emër të shtetasit L. Sula. Fitimi neto i vitit, në shumën 23.674 paund. Shpenzimet vjetore në shumën 12.570 paund. Të ardhurat e taksueshme në shumën 10.709 paund.
- Statement bankar nga Santander Bank, në emër të shtetasit L. Sula, për periudhën 09.03.2022 - 12.04.2023. Konfirmohet balanca e llogarisë, në shumën 246 paund. Kreditime në llogari në shumën 15.982 paund.

72.2 Në informacionin e datës 15.01.2024, subjekti ka sqaruar se: “...nuk ka dokumentacion tjetër për të vërtetuar të ardhurat e djalit për periudhën 2018 – 01.06.2022, pasi ka qenë pa letra dhe pagesa ka qenë cash. Shpenzimet kanë qenë të reduktuara pasi ka jetuar në shtëpinë e kushëririt të tij.”

- Deklaratë personale (jo noteriale) nga shtetasi I. Sula (kushëriri), i datës 10.01.2024, i cili ka deklaruar se: “...banon prej disa vitesh në Angli, me dokumentacion të rregullt dhe i vetëpunësuar në biznesin e tij privat. Gjithashtu deklaron se ka mbajtur djalin e xhaxhait të tij, shtetasin L. Sula, në banesën e tij, me ushqim dhe fjetje, pa asnjë shpenzim nga ana e tij, deri në momentin kur shtetasi L. Sula, ka marrë një banesë. Gjithashtu, ka sqaruar se tani shtetasit L. Sula, është me letra të rregullta në Angli, i vetëpunësuar tek biznesi që ai ka”.

72.3 Në informacionin e datës 15.01.2024, subjekti ka dorëzuar:

- Deklaratë (Statutory Declaration), në gjuhën angleze, e datës 26.06.2024, e dhënë pranë një zyre avokatie, ku shtetasi I. Sula, me nr. ID *****, banues në adresën *****, ka deklaruar se : *I ka ofruar ndihmë financiare, akomodim, ushqime, pagesë qiraje dhe shpenzime të tjera për shtetasin L. Sula, me banim në Mbretërinë e Bashkuar, nga data 28.10.2020 deri më datë 09.04.2022.*

72.4 Informacione nga sistemi “TIMS”, për shtetasin L. Sula, ku rezultojnë 4 dalje dhe 3 hyrje për periudhën 2018 – 2022. Konfirmohet një dalje/hyrje në vitin 2018, në datat 27.09.2018 – 11.10.2018; 2 dalje dhe 1 hyrje në vitin 2020 dhe konkretisht në datat 01.01.2020 – 02.01.2020 dhe dalje në datë 20.10.2020. Gjithashtu u konstatuan 2 hyrje/dalje në vitin 2022 dhe konkretisht në datat 01.05.2022 – 11.05.2022 dhe 28.07.2022 - 15.08.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Tenancy Agreement (marrëveshje qiraje), e datës 01.09.2021, midis L. Sula, A*** K***, G*** dhe A*** P*** dhe S*** L***, për periudhën 01.09.2021 - 31.08.2022, në shumën 970 paund në muaj.
- Me inventarin nr. extra prof., datë 07.12.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se djali i tij, L. Sula, gjatë periudhës nga data 31.08.2022 ka qëndruar tek nipi i subjektit I*** Sula, në Angli, i cili është me letra të rregullta prej shumë vitesh ku nuk ka paguar qira deri sa ka marrë banesën e tij me qira.
- Deklaratë personale (jo noteriale) nga shtetasi I. Sula (kushëriri), i datës 10.01.2024, pasqyruar në seksionin 73.3.
- Certifikatë familjare e datës 22.11.2023, ku tregohet gjendja familjare në datë 01.01.2023 me kryefamiljar z. Ilir Sula, në përbërjen familjare janë 7 anëtar, ndër të cilët dhe L. Sula.

Në përfundim të hetimit Trupa e Vlerësimit, konstaton se:

- ✓ **Të ardhurat nga paga/aktiviteti privat i djalit, për periudhën Mars 2022 - Mars 2023, rezultojnë në shumën rreth 26.900 paund.**
- ✓ **Shpenzime jetese, sipas deklarimit të subjektit janë rreth 12 - 14.000 paund në vit.**
- ✓ **Shtetasi L. Sula ka tre lëvizje hyrje - dalje në Angli, nga data 01.01.2020 31.12.2022 Shpenzimet për bileta janë 1.500 paund.**

DEKLARIMI I DJALIT – R. SULA

DEKLARIMI I PASURIVE

73 Jam student në shkollë të Lartë viti i 2-të, dega “*Software Engineer në University Canadian Institute of Technology*”, ku paguaj 2.450 Euro në vit.

Trajtuar me sipër në seksionin 60.

- ✓ **Shpenzimet për shkollim të shtetasit R. Sula, për periudhën 2021 -2023, janë në shumën 4.900, të cilat janë paguar nga kursimet familjare.**

DEKLARIMI I DJALIT – I. SULA

DEKLARIMI I PASURIVE

74 Pasuri të paluajtshme nuk disponoj, ndërsa pasuri të luajtshme disponoj një automjet të tipit Honda, model ACCORD, numër shasje ***** , në vlerën 1.000 dollar.

Zotëroj 100%.

Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e pagës së bashkëshortes dhe të mijat.

- 74.1 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë, si më poshtë vijon:
- Aplikim për targa automjeti në Michigan, në emër të shtetasit I. Sula, me vlerë 1.000 \$.
 - Certifikatë familjare datë 22.11.2023, ku tregohet gjendja familjare në datë 01.01.2023, me kryefamiljar Ilir Sula. Në përbërjen familjare janë 7 anëtarë, ndër të cilët dhe I. Sula dhe A. Pajollari
 - Certifikatë martese për shtetasin I. Sula me shtetasen A. Pajollari, ku konfirmohet martesa më datë 21.05.2021.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

75 I vetëpunësuar, me të ardhura mujore 2.880 \$. Nga periudha Shtator 2022 deri në Dhjetor 2022, në shumën 11.520 \$.

Dokumentacioni i marrë në shqyrtim:

- Nxjerrje llogarie në emër të shtetasit I. Sula nga Chase Bank, për periudhën 08.09.2022-15.12.2022. Konfirmohen kreditime në llogari (remote online deposit), në shumen totale rreth 18.068 \$. Balanca e llogarisë rrjedhëse në datë 15.12.2022, në shumën 4.193 USD dhe i llogarisë së kursimit në shumën 500 \$. (Nga statementi i paraqitur ka rezultuar se në dt.08.09.2022 ka kredituar në llogari shumën 7.000 \$).
- Në proces verbalin e datës 15.01.2024, subjekti ka deklaruar se: “...burimi i shumës 7.000 \$, ka qenë nga nipi i tij I. Sula dhe nga b/shortja e tij Th. Sula, si garanci ne momentin qe ka shkuar ne SHBA.
- Subjekti ka sqaruar se, në lidhje me mos deklarimin e llogarisë së fëmijëve dhe të nuses së djalit, nuk ka qenë në dijeni se duheshin deklaruar edhe llogarite bankare të tyre.”
- Kreditime në llogarinë e djalit në Chase Bank, SHBA, për periudhën Shtator 2022 - Dhjetor 2022, rezultojnë në shumën rreth 11.000 USD, konvertuar rreth 1.255.000 lekë.
- Shpenzime për udhëtimin e djalit në SHBA në vitin 2022, në shumën rreth 7.000 USD, konvertuar rreth 800.000 lekë.

✓ **Kreditime në llogarinë e djalit në Chase Bank, USA, për periudhën Shtator 2022 - Dhjetor 2022, rezultojnë në shumën rreth 11.000 USD, konvertuar rreth 1.255.000 lekë. (Janë quajtur kreditime, pasi nuk konfirmohen që janë depozituar nga ndonjë kompani apo biznes, por janë me shënimin Remote online deposits).**

✓ **Shpenzime për udhëtimin e djalit në USA në vitin 2022, në shumën rreth 7.000 USD, konvertuar rreth 800.000 lekë.**

76 Pasuri e luajtshme automjet, i tipit Honda, model ACCORD, numër shasje IHG*****0.
Trajtuar më sipër në seksionin 77.

77 Objekt i marrë me qira në qytetin Troy, SHBA. Pagesë qiraje 875 \$ në muaj, nga të ardhurat e pagës 2.880 \$ në muaj dhe pagës së bashkëshortes 2.458 \$.

- Kontratë qiraje datë 18.11.2022, për periudhën 01.11.2022 - 31.10.2023, në shumën 895 \$ në muaj, me qiramarrës shtetasen A. Pajollari (bashkëshortja) dhe shtetasin I. Sula (bashkëshorti).
- Sqarime me shkrim nga subjekti se: “...djali i tij, shtetasi I. Sula, së bashku me nusen e tij, shtetasen A. Pajollari, kanë emigruar në SHBA me “Lotari Amerikane” nga data 04.08.2022 e në vazhdim.”

✓ **Shpenzime për qira apartamenti në USA për periudhën Nëntor 2022 - Shkurt 2023, në shumën rreth 3.280 \$ (4 muaj).**

✓ **Shpenzime jetese dhe qira apartamenti në total rreth 15.100 \$, konvertuar rreth 1.625.000 lekë.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES SË DJALIT I. SULA – A. PAJOLLARI

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

78 Nga periudha shtator 2022 deri në dhjetor 2022, e punësuar si mjeke ndihmese, në “Beamount Hospital Troy”. Paga në shumën totale 9.832 dollar.

Dokumenti i marrë në shqyrtim:

- Intesa Sanpaolo Bank, konfirmon llogari page në monedhën euro, në emër të shtetasen A. Pajollari, për periudhën 30.07.2020 - 27.11.2020 në shumën 544 euro dhe 30.07.2021 - 03.11.2021 në shumën totale 273 euro.
- Union Bank, me shkresën nr. ***, datë 12.09.2023, konfirmon llogari page në emër të A. Pajollari, në shumën 22.000 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. ***, datë 06.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për shtetasen A. Pajollari, për periudhën Qershor - Gusht 2020 dhe Korrik - Gushi 2021.
- ISSH, Drejtoria e Arkivit Qëndron, me shkresën nr. V-Prot., datë 12.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.
- Nxjerrje llogarie në emër të A. Pajollari nga Comerica Bank, për periudhën 06.10.2022 - 20.12.2022. Konfirmohen kreditime në llogari në shumën totale rreth 7.750 \$. Balanca e llogarisë në dt. 20.12.2023, në shumën 2977 \$.
- Informacion nga sistemi Tims, për shtetasen A. Pajollari. Rezultojnë 4 dalje dhe 3 hyrje për periudhën 2020 - 2022. Konfirmohet dalja e fundit nga Shqipëria për vitin 2022, në dt. 04.08.2022.

- Bashkëlidhur informacionit të datës 19.12.2024 subjekti ka dorëzuar *një përmbledhje të të ardhurave*, për vitin 2022-2023, për shtetasen A. Pajollari.
- Nxjerrje llogarie në emër të shtetas A. Pajollari nga Comerica Bank, për periudhën 06.10.2022 - 20.12.2022. Konfirmohen kreditime në llogari, në shumën totale rreth 7.750 \$. Balanca e llogarisë në datë 20.12.2023, në shumën 2977 \$.

✓ **Të ardhurat nga paga e bashkëshortes së djalit, në Shqipëri dhe SHBA, për periudhën Korrik 2021 - Dhjetor 2022, rezultojnë në shumën rreth 22.000 lekë + 273 euro + 7.750 USD konvertuar rreth 887.000 lekë.**

78.1 **Shpenzime deri në Dhjetor 2022, rreth 4.773 dollar.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.**

79 Subjekti i vlerësimit, z. Ilir Sula, dhe personat e lidhur me të, kanë kryer transaksione të ndryshme në bankat Credins Invest, Unioni Financiar Tiranë, Ak-Invest dhe Easy Pay, për të cilat ka sqaruar: “ *se transaksionet e kryera nga shtetasja A. Pajollari, kanë qenë me lidhjet e saj familjare. Shtetasit Th. Sula dhe N. Sula, nuk kanë kryer asnjë transfertë parash. Shtetasi I. Sula ka dërgesa vetëm me vëllain e tij shtetasin R. Sula. Gjithashtu, shtetasja Th. Sula nuk është përfituese e transfertës 400 Euro. Djali L. Sula ka kryer një transfertë për A. Xh. (të dashurën e tij), në shumën 57.010 lekë.*

REZULTATE TË TJERA NGA HETIMI ADMINISTRATIV

80 Banka e Shqipërisë, BKT, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka ProCredit Bank, Fibank, Abi Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandesLease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar, AK Invest, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, IUTE CREDIT sha, Kreda.al, 15 Shoqëri Rajonale të UK, ONE Albania, Albanian Satellite Communication sh.p.k., Abissnet, *konfirmojnë se subjekti dhe persona e lidhur me të, nuk janë klient të tyre, çka përputhet me deklarin e tij.*

81 ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore - Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Lezhë, Lushnjë, Krujë, Kuçovë, Gjirokastrë, Tirana Jug, Malësi e Madhe Kukës, Kavajë, Bulqizë, Skrapar, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mirditë, Sarandë, Dibër, Pogradec, Vlorë, Dibër, Shkordër, Kurbin, *nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit apo personave të lidhur.*

82 Credins Invest, me shkresën nr. *** Prot., datë 07.09.2023, konfirmon Fond Pensioni “Credins Pension”, në emër të Th. Sula, hapur në datë 05.08.2015, me *balance* në datë 10.03.2023, në shumën 21.953 lekë.

83 Me inventarin nr. extra Prot., datë 07.12.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se ka qenë harresë nga ana e bashkëshortes, deklarimi i fondit të pensionit në shumën 21.953 lekë.

- Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me përgjigjen e ardhur nga Credins Invest.

84 Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. **** Prot., datë 14.09.2023, konfirmon se për periudhën 23.08.2018 - 10.03.2023, në emër të A. Pajollari, rezultojnë; 5 transaksione në hyrje, dhe, konkretisht, 1 në monedhën euro, ku është tërhequr shuma 200 euro; 2 në monedhën usd, ku është tërhequr shuma 350 usd dhe 2 në monedhën lekë, ku është tërhequr shuma 65.514 lekë dhe një transaksion në dalje, ku është dërguar shuma 1.145 euro.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË,

Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktoritetit dhe në shpjegimet e subjektit z. Ilir Sula, arriti në konkluzionin se:

- ✓ **Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e liqishme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të liqishme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

- Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:
 - (i) *të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
 - (ii) *raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
 - (iii) *verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, germa (ë), të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Ilir Sula, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të

papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:

- *Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;*
- *Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.*
- *Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.*

4. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42 pika 1, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot., datë 05.02.2024, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Ilir Isuf Sula.
5. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:
 - Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
 - Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
 - Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.
 - Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.
 - Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë.
6. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, plotësuar nga subjekti, ndër të tjera vërehet se:
 - 6.1 Pyetjes “A keni pasur emër apo mbiemër tjetër më parë”, subjekti i vlerësimit është përgjigjur me “JO”.
 - 6.2 Përsa i përket pyetjeve nëse ka qenë në hetim/gjykim, nëse ka qenë i ndaluar/arrestuar, nëse është caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale”, subjekti i vlerësimit është përgjigjur me “PO”.

HETIMI ADMINISTRATIV

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, janë kryer verifikime duke kërkuar të dhëna nga institucionet, agjencitë ligjzbatuese, nga ku ka rezultuar si vijon:

7. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën “Paklasifikuar” nr.*** Prot., datë 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Me datë 15.06.1976, ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit nga “Suma” në “Sulaj” sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974 “Qinamak”, me referencë 1/94. Gjatë transkriptimit të të dhënave në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, “Fushar”, me referencë 1/32, të administruar po nga zyra e gjendjes civile në Njësinë Administrative Surroj, Bashkia Kukës, rubrika e mbiemrit është hedhur “Sula”, për të cilën nuk ka asnjë shënim lidhur me ndonjë vendim ndryshimi. Me rubrikën e mbiemrit “Sula” është vendosur dhe në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Administrative Paskuqan, e dhënë me të cilën rezulton dhe aktualisht në RKGJC.

8. Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

“Nuk kam pasur emër apo mbiemër tjetër më parë”.

8.1 Nga korrespondenca me postë elektronike, me subjektin e vlerësimit Ilir Sula, i cili është pyetur në lidhje me këtë fakt, ka dhënë shpjegimet si më poshtë:

“Lidhur me faktin, e ndryshimit të rubrikës së mbiemrit nga “Suma” në “Sulaj” sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974 “Qinamak”, me referencë 1/94, (kohë në të cilën subjekti ka qenë 4 vjeç), dua të them se për këtë fakt jam vënë në dijeni nëpërmjet postës elektronike të dërguar nga ana Juaj. Nuk kam pasur dijeni më parë, pasi në atë moshë kur prindërit kanë ndryshuar mbiemrin kam qenë i vogël dhe nuk jam vënë në dijeni nga ana e tyre.

Regjistrimi im në shkollën fillore ka qenë me mbiemrin “Sula”.

Siç e thash dhe më sipër, arsyeja e mos deklarimit në Deklaratën për Kontrollin e Figurës për Vlerësimin Kalimtar, është mos pasja dijeni e këtij fakti.”

8.2 Në bazë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Trupa e Vlerësimit konstatoi se:

- Në lidhje me ndryshimin e mbiemrit të familjes së subjektit të vlerësimit Ilir Sula, kryer në vitin 1974, në atë periudhë kohe rezulton që subjekti të ketë qenë rreth moshës 4 vjeç dhe që nga viti 1974 e deri më sot bëhen rreth 50 vite më parë. Si dhe mungesës së plotë të zotësisë juridike për të kryer veprime juridike për periudhën para vitit 1974 nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ndryshimin e gjeneraliteteve nga ana e subjektit të vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi të kohës.
- Për këtë arsye vlerësojmë se, mospasqyrimi i ndryshimit të mbiemrit në formularin e Kontrollit të Figurës nga subjekti i vlerësimit, nuk kategorizohet tek përcaktimet e nenit 42, pika 3, germa “a” e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

9. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 10.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Me vendimin nr. ***, date 03.12.1999 Gjykata e rrethit Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” e në bazë të Nenit 250 të K. Penal,

është dënuar me kohën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak e cila fillon me datë 03.12.1998 deri me 05.12.1999.

- Rehabilitohet në bazë të Nenit 69 të K. Penal.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se;

*“...në vitin 1997 jam marrë në përgjegjësi penale “Kryerjen e veprimeve arbitrare”, me Vendim nr. ** të Gjykatës Kushtetuese datë 18.04.2000, ka nxjerrë deklarin anti kushtetues të vendimit nr. ***, datë 03.12.1998, të Gjykatës së rrethit Tiranë dhe nr. ***, datë 23.06.1996 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë...”*

9.1 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën Nr.*** Prot, datë 10.08.2023, na vë në dispozicion vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore, për subjektin e vlerësimit z. Ilir Isuf Sula, ku citohet se:

- Me vendimin nr. ***, datë 03.12.1999 Gjykata e rrethit Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “Kryerjes së Veprimeve Arbitrare” e në bazë të Nenit 250 të K. Penal është dënuar me kohën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak e cila fillon më datë 03.12.1998 deri me 05.12.1999.
- Rehabilitohet në bazë të Nenit 69 të K. Penal.
- Me vendimin nr. ** të Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal, më jepen të gjithë të drejtat, duke lënë në fuqi vendimin nr. **, datë 01.02.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë. (Pushim të çështjes penale).

9.2 Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, me shkresën nr. ***, datë 31.10.2023, ka vënë në dispozicion përgjigjen e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. ***, datë 19.09.2023, e cila bën me dije Drejtorinë e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme se:

*“...nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 1990-2023 **nuk rezultoi** që ndaj shtetasit Ilir Isuf Sula, të jenë regjistruar procedime penale në ngarkim.”*

Gjithashtu, Trupa e vlerësimit ka administruar vendim të Gjykatës Kushtetuese, vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilën është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të shtetasit Ilir Sula.

10. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se në ngarkim të tyre nuk rezultojnë të përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të kenë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.

11. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë ", i ndryshuar);
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
- Nuk kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.

12. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Konfidencial”, Nr. *** Prot, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Nuk disponon të dhëna.

13. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 03.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- Nuk ka procedim penal të referuar;
- Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

14. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 31.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;

- Nuk ka pasur raste të urdhreve ndërkombëtar të ndalimit.

15. Institucion liqzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
- Nuk ka pasur raste të urdhreve ndërkombëtar të ndalimit.

16. Institucion liqzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- Nuk rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit Ilir Sula;
- Rezultuan raportime për personat e lidhur A. Pajollari dhe I. Sula, sipas Aneks 1.
- Nuk rezultuan raportime për personat e lidhur Th. Sula, L. Sula, R. Sula dhe N. Sula.

17. Institucion liqzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Z. Ilir Isuf Sula, me nr. personal (ID) ***, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), me nr. ***, në nivelin "Tepër Sekret", lëshuar më datë 11.08.2023, e vlefshme deri më datë 10.08.2028.
- Nga AKSIK, nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
- AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO/BE, si dhe të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

18. Institucion liqzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

19. Institucion liqzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Isuf Sula, bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku:

20. Për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, nuk është disponuar asnjë ankese nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për denoncime nga publiku për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

21. Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit z. Ilir Sula:

- Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit z. Ilir Sula, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Ilir Isuf Sula:

✓ **Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;**

✓ **Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

22. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

23. Periudha e vlerësimit të aftësive profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e nenit 44 pika 2 dhe 3 të ligjit të vlerësimit.

24. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

25. Subjekti i vlerësimit z. Ilir Isuf Sula, më datë 10.03.2023, ka dorëzuar në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Formularin e

Vlerësimi të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi mbante detyrën e “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Shkodër - Lezhë”.

- Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “është periudha 5 – vjeçare (2018 – 2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shtrihet brenda këtij harku kohor”.

RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL NGA DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PRANË AMP-së.

26. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport i hollësishëm për subjektin e vlerësimit Ilir Sula, me shkresën nr. *** Prot, datë 19.09.2023, i përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale, ku ka rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i burimeve të mësipërme, mbi të cilat është mbështetur ky raport vlerësimi, konstatohet dhe relatojmë si vijon:

27. Të dhëna për Arsimin:

- Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2/a të ligjit 12/2018, të ndryshuar.

27.1 Pas verifikimit të diplomës sipas shkresës kthim përgjigje nr. ***** datë 15.08.2023, rezulton se subjekti i vlerësimit ka kryer studimet si më poshtë:

- Ka filluar studimet pranë Shkollës së Lartë të M.P.B në “Akademinë e Sigurisë” pa shkëputje nga puna, në vitin 1991 dhe i ka përfunduar më datë 1996. U diplomua në degën “Policë”, diplomë seria “B” me nr. Amze *** datë 23.09.1996
- Ka filluar studimet pranë Akademisë së Forcës Tokësore “Skënderbej”, me vendim të komisionit shtetëror me nr.**, datë 21.02.1993, “Diplomohet oficer për specialitetin Zbulim”, me nr. ***, nr. Amze ***, datë 22.02.1993.
- Në periudhën 13.01.2011, ka marrë certifikatë lavdërimi për rezultate në Sigurimin e Rendit Publik, “Për përkushtimin e treguar dhe arritjen e rezultateve të larta në luftën ndaj krimit, ruajtjes së sigurisë dhe rendit publik, lëshuar nga Ministria e Brendshme”.
- Në periudhën 19.01.2004 – 25.01.2004, ka përfunduar kursin e trajnimit për trajnues të formimit profesional të punonjësve të Policisë së Shtetit, në Rolin Bazë.

27.2 Në kuptim të legjislacionit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në vite dhe Ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, VKM-së nr. 532, datë 29.07.2022, “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, rezulton se:

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konkludon se niveli arsimor për funksionin që ushtron pranë AMP-së, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale është në përputhje me ushtrimin e detyrës.**

28. Të dhëna për punësimin dhe ecuria në karrierë.

Subjekti i vlerësimit z. Ilir Sula, ka një karrierë në Policinë e Shtetit rreth 21 vite dhe rreth 2 vite pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, objekt deklarimi, subjekti i vlerësimit nuk ka qenë pjesë e strukturave të Policisë, AMP-së apo Gardës së Republikës, objekt vlerësimi.

28.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban ecurinë në karrierë ku subjekti ka ushtruar funksione drejtuese si: Shef Sektori, Shef Komisariati, Zëvendësdirëtor pranë DPPSH-së. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye ecuria në karrierë nuk do të trajtohen në kuadrin e ecurisë në karrierë nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018 – mars 2023).

28.2 Neni 45, pika 2, shkronja (c), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar përcakton se:

- Në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.

✓ **Nga aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore të AMP-së, rezulton se gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit nuk ka punuar në struktura të administratës publike dhe nuk disponon asnjë vlerësim pune në dosjen e tij personale. Kjo për arsye se subjekti i vlerësimit nuk ka qenë pjesë e strukturave objekt vlerësimi.**

29. Të dhëna për kualifikimet dhe trajnimet.

- Në pikën 3, të formularit të aftësive profesionale, subjekti përgjatë viteve deklaron pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit, kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit duke cituar edhe certifikatat përkatëse të marra lidhur me këto veprimtari.

29.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit, të një periudhë që nuk përfshihet në harkun kohor të sipër cituar. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018 – mars 2023)

29.2 Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë “certifikatë lavdërimi për performacë të lartë në Sigurinë e Rendit Publik”.

Trupa e Vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të AMP-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatohet se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, të vlerësimit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- Nuk ka realizuar asnjë trajnim;
 - Nuk ka asnjë kualifikim;
 - Nuk ka marrë asnjë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.
- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti nuk gëzon asnjë kualifikim/trajnim/medalje.**
- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
30. **Të dhëna mbi pjesëmarrje në konferenca shkencore, workshope apo botime.**
- Subjekti i vlerësimit Ilir Sula për periudhën 2018 – mars 2023, nuk ka marr pjesë në asnjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.
31. **Bashkëpunimi i subjektit gjatë Procesit të Vlerësimit.**
- Gjatë hetimit, trupa vlerësuese ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e vlerësimit, duke i bërë pyetje dhe ka kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupa Vlerësuese konstaton se subjekti ka qenë bashkëpunues gjatë të gjithë procesit në përputhje me pikën 2 të nenit 48 të ligjit 12/2018, të ndryshuar.

Në përfundim të hetimit të kryer mbi vlerësimin e aftësive profesionale:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit z. Ilir Isuf Sula:

- ✓ **Është i përshtatshëm për funksionin që mbanë, pasi ka arsimin/trajnimin përkatës;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.**
- ✓ **Nuk ka asnjë vlerësim pune për periudhën e vlerësimit.**

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatorit të çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 19.02.2025, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 28.02.2025, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Ilir Isuf Sula, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Ilir Isuf Sula**, me funksion Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Shkodër – Lezhë”.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 28.02.2025.

TRUPA E VLERËSIMIT

Ersa KARAJ
Kryesuese

Elida DOMI
Relatore

Erjana PJETRI
Anëtare